

LIGJ
Nr.9263, datë 29.7.2004

PËR RATIFIKIMIN E “KONVENTËS SË STOKHOLMIT “PËR NDOTËSIT ORGANIKË TË QËNDRUESHËM””

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 121 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Ratifikohet “Konventa e Stokholmit “Për ndotësit organikë të qëndrueshëm””.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.4292, datë 2.8.2004 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Alfred Moisiu

KONVENTA E STOKHOLMIT MBI NDOTËSIT ORGANIKË TË QËNDRUESHËM

A. Hyrje

Palët në këtë Konventë,

Duke ditur se ndotësit organikë të qëndrueshëm kanë veti toksike, i rezistojnë degradimit, akumulohen biologjikisht dhe transportohen përmes ajrit, ujit dhe specieve shtegtare, nëpër kufijtë ndërkombëtarë dhe depozitohen larg nga vendi që i çliron ata, kur akumulohen në ekosistemet tokësore dhe ujore,

të ndërgjegjshëm për problemet shëndetësore, veçanërisht në vendet në zhvillim, që rezultojnë nga ekspozimi lokal ndaj ndotësve organikë, të qëndrueshëm, veçanërisht ndikimet te gratë dhe, përmes tyre, te brezat e ardhshëm,

duke pranuar se ekosistemet arktike dhe komunitetet vendase janë veçanërisht në rrezik për shkak të shtimit biologjik të ndotësve organikë të qëndrueshëm dhe se infektimi i ushqimeve të tyre tradicionale është një çështje e shëndetit publik,

të ndërgjegjshëm për nevojën e një veprimi global mbi ndotësit organikë, të qëndrueshëm,

duke mbajtur ndër mend vendimin 19/13 C të 7 shkurtit 1997 të Këshillit Drejtues të Programit për Mjedisin të Kombeve të Bashkuara për të filluar veprimin ndërkombëtar për ruajtjen e shëndetit të njerëzve dhe mjedisin nëpërmjet masave të cilat do të reduktojnë dhe eliminojnë përhapjet dhe shkarkimet e ndotësve organikë të qëndrueshëm,

duke rikujtuar nenet përkatëse të konventave ndërkombëtare në lidhje me mjedisin, veçanërisht Konventën e Roterdamit mbi procedurën e miratimit të njoftuar paraprakisht për kimikate dhe pesticide të rrezikshme të caktuara në tregtinë ndërkombëtare dhe Konventën e Baselit mbi

kontrollin e lëvizjeve ndërkufitare të mbeturinave të rrezikshme dhe asgjësimin e tyre, duke përfshirë edhe marrëveshjet rajonale të zhvilluara brenda kuadrit të nenit 11 të saj,

duke rikujtuar gjithashtu nenet përkatëse të Deklaratës së Rio de Zhanejros mbi Mjedisin dhe Zhvillimin dhe Axhendën 21,

duke pranuar se masat paraprake janë shqetësim i të gjitha palëve dhe mishërohen brenda Konventës,

duke ditur se kjo Konventë dhe marrëveshje të tjera ndërkombëtare në fushën e tregtisë dhe të mjedisit mbështesin njëra-tjetrën në mënyrë reciproke,

duke riafirmuar se në përputhje me Kartën e Kombeve të Bashkuara parimet e ligjit ndërkombëtar, shtetet kanë të drejtën e tyre sovraane për të shfrytëzuar burimet e veta në zbatim të politikave të veta të mjedisit dhe të zhvillimit dhe përgjegjësinë për të garantuar se aktivitetet brenda juridiksionit ose nën kontrollin e tyre nuk i shkaktojnë dëme mjedisit të shteteve të tjera ose të zonave përtej kufijve të juridiksionit kombëtar,

duke marrë parasysh rrethanat dhe kërkesat e veçanta të vendeve në zhvillim, në veçanti të atyre më pak të zhvilluar midis tyre dhe të vendeve me ekonomi në tranzicion, veçanërisht nevoja për të forcuar kapacitetet e tyre kombëtare për administrimin e kimikateve, duke përfshirë transferimin e teknologjisë, sigurimin e asistencës financiare dhe teknike dhe nxitjen e bashkëpunimit midis Palëve,

duke pasur parasysh Programin e Veprimit për Zhvillim të Qëndrueshëm të shteteve të vegjël në zhvillim, të adoptuar në Barbados më 6 maj 1994,

duke vënë në dukje kapacitetet respektive të vendeve të zhvilluara dhe atyre në zhvillim, si dhe përgjegjësitë e përbashkëta, por të diferencuara të shteteve, siç përcaktohet në parimin 7 të Deklaratës së Rios mbi Mjedisin dhe Zhvillimin,

duke e ditur kontributin e rëndësishëm që mund të japin sektori privat dhe organizatat joqeveritare në reduktimin dhe eliminimin e përhapjes dhe shkarkimit të ndotësve organikë të qëndrueshëm,

duke nënvizuar rëndësinë që ka marrja e përgjegjësisë nga prodhuesit e ndotësve organikë të qëndrueshëm për reduktimin e efekteve të kundërta të shkaktuara nga produktet e tyre dhe për t'i dhënë informacion përdoruesve, qeverive dhe publikut mbi vetitë e rrezikshme të atyre kimikateve,

të ndërgjegjshëm për nevojën e marrjes së masave për të parandaluar efektet e kundërta të shkaktuar nga ndotësit organikë të qëndrueshëm në të gjitha fazat e jetëgjatësisë së tyre,

duke riafirmuar parimin 16 të Deklaratës së Rios mbi mjedisin dhe zhvillimin, i cili përcakton se autoritetet kombëtare duhet të përpiqen të nxisin mbulimin e kostos për mjedisin brenda vendit dhe përdorimin e instrumeneteve ekonomike, duke pasur parasysh metodën që subjekti që shkakton ndotjen, në parim, duhet të përballojë koston e ndotjes, në lidhje me interesin publik dhe pa shtrembëruar tregtinë dhe investimet ndërkombëtare,

duke inkurajuar palët, që nuk kanë skema rregulluese dhe vlerësimi për pesticidet dhe kimikateve, të zhvillojnë skema të tilla,

duke ditur rëndësinë e zhvillimit dhe të përdorimit të proceseve dhe kimikateve ambientalisht të shëndosha,

të vendosur për të mbrojtur shëndetin e njeriut dhe mjedisin nga ndikimet e dëmshme të ndotësve organikë të qëndrueshëm,

kanë rënë dakord si më poshtë:

B. Objektivi

Duke pasur parasysh metodën e masave paraprake të përcaktuara në parimin 15 të Deklaratës së Rios mbi mjedisin dhe zhvillimin, objektivi i kësaj Konvente është të mbrojë shëndetin e njeriut dhe mjedisin nga ndotësit organikë të qëndrueshëm.

C. Përkufizime

Për qëllimet e kësaj Konvente:

a) “Palë” do të thotë shtet ose organizatë rajonale e integritit ekonomik që ka parapëlqyer të lidhet me këtë Konventë dhe për të cilën Konventa është në fuqi.

b) “Organizatë rajonale e integritit ekonomik” do të thotë një organizatë e përbërë nga shtete sovraane të një rajoni të dhënë, të cilës shtetet anëtare të saj i kanë dhënë kompetencë në lidhje me çështjet që rregullohen nga kjo Konventë dhe që është autorizuar siç duhet, në përputhje me procedurat e brendshme të saj, për të nënshkruar, ratifikuar, pranuar, aprovuar dhe për t'u bashkuar me këtë Konventë.

c) "Palët prezente dhe votimi" do të thotë palët e pranishme dhe që hedhin një votë pro ose kundër.

D.Masat për të reduktuar ose eliminuar shkarkimin e ndotësve organikë të qëndrueshëm
Prodhimi i paramenduar dhe përdorimi

1. Çdo palë:

a) do të ndalojë ose marrë masa ligjore dhe administrative të nevojshme për të eliminuar:

i) prodhimin dhe përdorimin e kimikateve të listës në shtojcën A, duke iu nënshtruar kushteve të kësaj shtojce dhe

ii) importimin dhe eksportimin e kimikateve të listës në shtojcën A, në përputhje me kushtet e paragrafit 1 bis të nenit D;

b) do të kufizojë prodhimin dhe përdorimin e kimikateve të listës B, në përputhje me kushtet në atë shtojcë.

1 bis. Çdo palë duhet të marrë masa për të siguruar:

a) që një kimikat i listës në shtojcën A ose B të importohet vetëm:

i) me qëllim asgjësimit ambientalisht të pastër të tyre ose

ii) për një përdorim ose qëllim, i cili lejohet për atë Palë sipas shtojcës A ose B;

b) që një kimikat i listës në shtojcën A, për çdo prodhim ose përdorim të të cilit një përjashtim i veçantë është në fuqi, ose një kimikat i listës në shtojcën B për çdo prodhim ose përdorim të të cilit një përjashtim i veçantë ose qëllim i pranueshëm është në fuqi, duke marrë parasysh kushtet përkatëse në instrumentet ekzistuese të pranimit të njoftuara paraprakisht, eksportohet vetëm:

i) me qëllim asgjësimit ambientalisht të pastër të tyre;

ii) të një palë, e cila lejohet të përdorë atë kimikat sipas shtojcës A ose shtojcës B; ose

iii) të një shteti jo palë i kësaj Konvente, i cili ka paraqitur një certifikatë vjetore të pala eksportuese. Një certifikatë e tillë duhet të specifikojë përdorimin e paramenduar të kimikatit dhe të përfshijë një deklaratë se, lidhur me atë kimikat, shteti importues angazhohet:

a) të mbrojë shëndetin e njerëzve dhe mjedisin, duke marrë masa të nevojshme për të minimizuar ose parandaluar shkarkimin e ndotësve;

b) të veprojë në përputhje me kushtet e paragrafit 4 të nenit D; dhe

c) të veprojë në përputhje, kur është e përshtatshme, me kushtet e paragrafit 2 pjesa II-të shtojcës B.

Certifikimi do të përfshijë gjithashtu çdo dokumentacion mbështetës përkatës, si legjislacioni, instrumentet rregulluese ose direktivat administrative dhe politike. Pala eksportuese do të transmetojë certifikimin të sekretariatit brenda gjashtë ditëve pas marrjes.

c) Që një kimikat i listës në shtojcën A, për çdo prodhim ose përdorim të cilit nuk ka më përjashtim të veçantë në fuqi për çdo palë, nuk eksportohet nga ajo Palë veçse për qëllime të asgjësimit ambientalisht të pastër.

d) Për qëllimet e këtij paragrafi, termi "Shtet jo Palë në këtë Konventë" do të përfshijë, lidhur me një kimikat të veçantë, një shtet ose organizatë rajonale e integritit ekonomik, që nuk ka rënë dakord të lidhet me Konventën lidhur me atë kimikat.

2 bis. Çdo palë që ka një ose më shumë skema rregulluese dhe vlerësimi për pesticidet ose kimikatet e reja industriale, do të marrë masa me qëllim parandalimit të prodhimit dhe të përdorimit të pesticideve të reja dhe kimikateve industriale të reja të cilat, duke marrë në konsideratë kriteret e paragrafit 1 të shtojcës D, shfaqin karakteristikat e ndotësve organikë të qëndrueshëm.

2 ter çdo palë që ka një ose më shumë skema rregulluese dhe vlerësimi për pesticidet ose kimikatet e reja industriale, kur është e përshtatshme, do të marrë në konsideratë kriteret e paragrafit 1 të shtojcës D kur bëhen vlerësimet e pesticideve ose kimikateve industriale aktualisht në përdorim.

5. Me përjashtim të rasteve kur përcaktohet ndryshe në këtë Konventë, paragrafët 1 dhe 1 bis nuk aplikohen për sasitë e kimikateve që përdoren për punë kërkimore në shkallë laboratoriale ose si standard referimi.

6. Çdo palë që ka një përjashtim të veçantë në përputhje me shtojcën A ose një përjashtim të veçantë a një qëllim të pranueshëm në përputhje me shtojcën B, do të marrë masa përkatëse për të siguruar që çdo prodhim ose përdorim, sipas çdo përjashtimi ose qëllimi, kryhet në një mënyrë që parandalon ose minimizon ekspozimin e njeriut dhe shkarkimin në mjedis. Për përdorimet e përjashtuara ose qëllimet e pranueshme që përfshijnë shkarkimin e paramenduar në mjedis, sipas

kushteve të përdorimit normal, një shkarkim i tillë do të jetë në shkallën minimale të nevojshme, duke marrë parasysh çdo standard dhe direktivë të zbatueshme.

Prodhimi jo i paramenduar

Çdo Palë, minimalisht, do të marrë masat e mëposhtme për të reduktuar shkarkimet e përgjithshme që rrjedhin nga burimet antropogjene të çdo kimikati të listës në shtojcën C, me qëllim vazhdimin e minimizimit dhe, kur është e mundur, eliminimin përfundimtar të tyre:

a) Të zhvillojë një plan veprimi ose, kur është e përshtatshme, një plan veprimi rajonal ose nënrajonal brenda dy viteve nga data e hyrjes në fuqi të kësaj Konvente për të, dhe më pas ta zbatojë si pjesë të planit të zbatimit të specifikuar në nenin që shërben për të identifikuar, karakterizuar dhe adresuar shkarkimin e kimikateve të listës në shtojcën C dhe për të lehtësuar zbatimin e pikave (b) deri (e). Plani i veprimit do të përfshijë elementet e mëposhtme:

i) Një vlerësim i shkarkimeve aktuale dhe të projektuara, duke përfshirë zhvillimin dhe ruajtjen e inventarëve të burimeve dhe vlerësimet e shkarkimeve, duke marrë në konsideratë kategoritë e burimeve të identifikuar në shtojcën C;

ii) Një vlerësim i efikasitetit të ligjeve dhe politikave të palës që lidhet me administrimin (menaxhimin e shkarkimeve të tilla.).

iii) Strategjitë për të plotësuar detyrimet e këtij paragrafi, duke marrë parasysh vlerësimet në (i) dhe (ii);

iv) Hapa për të nxitur arsimimin dhe trajnimin lidhur me këto strategji;

v) Një rishikim çdo pesë vjet i atyre strategjive dhe i suksesit të tyre në plotësimin e detyrimeve të këtij paragrafi; rishikime të tilla do të përfshihen në raportet e dorëzuara në pajtim me nenin L;

vi) Një grafik për zbatimin e planit të veprimit duke përfshirë strategjitë dhe masat e identifikuar atje;

b) Të nxisë zbatimin e masave praktike dhe të mundshme në dispozicion që mund të realizojnë në mënyrë të shpejtë një nivel realist dhe kuptimplotë të reduktimit të shkarkimit ose eliminimin e burimit;

c) Të nxisë zhvillimin dhe, kur e gjykon të arsyeshme, të kërkojë përdorimin e materialeve, produkteve dhe proceseve zëvendësuese ose të modifikuara për të parandaluar formimin dhe shkarkimin e kimikateve të listës në shtojcën C, duke marrë në konsideratë direktivën e përgjithshme mbi masat e parandalimit dhe të reduktimit të shkarkimit në shtojcën C dhe direktivat që duhen adoptuar nga vendimi i konferencës së palëve;

d) Të nxisë dhe, në përputhje me afatet e zbatimit të planit të vet të veprimit, të kërkojë përdorimin e teknikave më të mira të mundshme për burimet e reja brenda kategorive të burimeve që një Palë ka identifikuar si garantuese të veprimit të tillë në planin e tij të veprimit, duke u përqendruar në mënyrë të veçantë te kategoritë e burimeve të identifikuar në pjesën II të shtojcës C. Kërkesa për të përdorur teknikat më të mira në dispozicion për burimet e reja në kategoritë e listës në pjesën II të asaj shtojce do të ndahen në faza sa më shpejt që të jetë praktike, por jo më vonë se katër vjet pas hyrjes në fuqi të Konventës për palën. Për kategoritë e identifikuar, palët do të nxisin përdorimin e praktikave mjedisore më të mira. Kur aplikojnë teknika më të mira në dispozicion dhe praktikat mjedisore më të mira, palët duhet të marrin në konsideratë direktivën e përgjithshme mbi masat e parandalimit dhe të reduktimit, shkarkimit në atë shtojcë dhe direktivat mbi teknikat më të mira në dispozicion, dhe praktikat mjedisore më të mira që duhen adoptuar nga vendimi i konferencës së palëve;

e) Të nxisë, në përputhje me planin e vet të veprimit, përdorimin e teknikave më të mira në dispozicion dhe praktikave mjedisore më të mira:

i) Për burimet ekzistuese, brenda kategorive të listës në pjesën II dhe brenda kategorive të tilla si ato të pjesës III të shtojcës C; dhe

ii) Për burimet e reja, brenda kategorive të burimeve si ato të listës në pjesën III të shtojcës C, të cilave një Palë nuk i është adresuar sipas nënparagrafit (d).

Për aplikimin e teknikave më të mira në dispozicion dhe praktikave mjedisore më të mira, palët duhet të marrin në konsideratë direktivën e përgjithshme mbi masat e parandalimit dhe të reduktimit të shkarkimit në atë shtojcë, dhe direktivat mbi teknikat më të mira në dispozicion dhe praktikat mjedisore më të mira që duhen adoptuar nga vendimi i konferencës së palëve;

Për qëllimet e këtij paragrafi dhe shtojcës C:

i) “Teknikat më të mira në dispozicion” do të thotë fazat me efektive dhe më të përparuara në zhvillimin e aktiviteteve dhe metodat e tyre të veprimit, të cilat tregojnë përshtatshmërinë praktike të teknikave të veçanta për sigurimin në parim të bazës për kufizimet e shkarkimit që shërbejnë për të parandaluar dhe, ku ajo nuk është e praktikueshme, përgjithësisht për të reduktuar shkarkimet e kimikateve të listës në pjesën (i) të shtojcës C dhe ndikimi i tyre mbi mjedisin në tërësi. Lidhur me këtë:

ii) “Teknikat” përfshijnë si teknologjinë e përdorur, edhe mënyrën në të cilën është projektuar, ndërtuar, mirëmbajtur, funksionojë instalimi;

iii) “Në dispozicion” do të thotë ato teknika që janë të lejueshme për operatorin dhe që janë të zhvilluara në një shkallë që lejon zbatimin në sektorin industrial përkatës sipas kushteve të qëndrueshme ekonomikisht dhe teknikisht, duke marrë parasysh kostot dhe avantazhet;

iv) “Më i mirë” do të thotë më efektiv në arritjen e një niveli të përgjithshëm të lartë të mbrojtjes së mjedisit në tërësi;

v) “Praktika mjedisore më të mira” do të thotë aplikimi i kombinimit më të përshtatshëm të masave dhe strategjive të kontrollit të mjedisit;

vi) “Burim i ri” do të thotë çdo burim nga i cili fillon ndërtimi ose modifikimi i rëndësishëm të paktën një vit pas datës së:

a) hyrjes në fuqi të kësaj Konvente për palët e interesuara; ose

b) hyrjes në fuqi për palët e interesuara të një amendamenti të shtojcës C, ku burimi iu nënshtrohet kushteve të kësaj Konvente vetëm në sajë të këtij amendamenti.

f bis) Vlerat kufi të shkarkimit ose standardet e kryerjes mund të përdoren nga një palë për të plotësuar angazhimet e saj për teknikat më të mira në dispozicion sipas këtij paragrafi.

Grumbujt dhe mbeturinat

4. Për të siguruar që grumbujt përbëhen ose përmbajnë kimikate të listës në shtojcat A ose B dhe mbeturinat, duke përfshirë produktet dhe artikujt pas kthimit të tyre në mbeturina, përbëhen, përmbajnë ose infektohen nga një kimikat i listës në shtojcat A, B ose C administrohen në mënyrë që të mbrojnë shëndetin e njerëzve dhe mjedisin, çdo palë:

a) do të zhvillojë strategjitë përkatëse për të identifikuar:

i) grumbujt që përbëhen ose përmbajnë kimikate të listës në shtojcat A ose B;

ii) produktet dhe artikujt në përdorim dhe mbeturinat që përbëhen, përmbajnë apo identifikohen nga një kimikat i listës në shtojcat A, B ose C;

b) do të identifikojë, deri në shkallën më praktike, grumbujt që përbëhen ose përmbajnë kimikate të listës në shtojcat A ose B mbi bazën e strategjive që iu referuam në nënparagrafin (a);

c) do të administrojë grumbujt, si të jetë e përshtatshme, në mënyrë të sigurt dhe ambientalisht të pastër. Grumbujt e kimikateve të listës në shtojcat A ose B, pasi ato nuk lejohet të përdoren më sipas çdo përjashtimi të veçantë a qëllimi të pranueshëm të specifikuar në shtojcën A ose çdo përjashtimi a qëllimi të pranueshëm të specifikuar në Shtojcën B, përveç grumbujve që lejohen të eksportohen sipas paragrafit 1 bis të nenit D, do të gjykohen si mbeturina dhe do të administrohen sipas nënparagrafit (d);

d) do të marrë masat përkatëse në mënyrë që mbeturina të tilla, duke përfshirë produktet dhe artikujt pas kthimit në mbeturina:

i) do të trajtohen, do të grumbullohen, transportohen dhe do të ruhen në mënyrë ambientalisht të pastër;

ii) do të asgjësohen në mënyrë të tillë që përmbajtja e ndotësit organik të qëndrueshëm shkatërrohet ose transformohet krejtësisht në mënyrë që ato nuk shfaqin karakteristikat e ndotësve organikë të qëndrueshëm, ose ndryshe asgjësohen në mënyrë ambientalisht të pastër kur shkatërrimi ose transformimi i pakthyeshëm nuk paraqet opcionin ambientalisht të preferueshëm ose kur përmbajtja me ndotës organikë të qëndrueshëm është e ulët, duke pasur parasysh ligjet ndërkombëtare, standardet dhe direktivat, ku përfshihen edhe ato që mund të zhvillohen në pajtim me paragrafin 4 bis dhe regjimet përkatëse globale dhe rajonale që rregullojnë administrimin e mbeturinave të rrezikshme;

iii) nuk lejohet t’i nënshtrohen operacioneve të shkatërrimit që mund të çojnë në përmirësim, riciklim, riaftësim, përdorim të drejtpërdrejtë ose përdorime alternative të ndotësve organikë të qëndrueshëm;

iv) nuk transportohen nëpër kufijtë ndërkombëtarë pa marrë parasysh rregullat, standardet dhe direktivat ndërkombëtare;

e) përpiqen të zhvillojnë strategjitë përkatëse për identifikimin e vendeve të infektuara nga kimikate të listës në shtojcat A, B dhe C; në qoftë se ndërmerret një veprim për ndreqjen e atyre vendeve, ai duhet të kryhet në mënyrë ambientalisht të pastër.

4 bis. Konferenca e palëve do të bashkëpunojë ngushtë me organet përkatëse të Konventës së Baselit mbi lëvizjen ndërkufitare të mbeturinave të rrezikshme dhe asgjësimin e tyre *inter alia*:

i) për të vendosur nivelet e shkatërrimit dhe të transformimit të pakthyeshem të nevojshme për të siguruar që karakteristikat e ndotësve organikë të qëndrueshem siç specifikohet në paragrafin 1 të shtojcës D nuk shfaqen;

ii) për të përcaktuar ato që ata i konsiderojnë se janë metodat që përbëjnë shkatërrimin ambientalisht të pastër referuar si më sipër; dhe

iii) për të punuar për të vendosur, siç është e përshtatshme, nivelet e përqendrimit të kimikateve të listës në shtojcat A, B dhe C, me qëllim që të përcaktohet përmbajtja e ulët e ndotësve organikë të qëndrueshem referuar në (d)(ii) të paragrafit 4.

R bis. Regjistër i përjashtimeve të veçanta

Është krijuar për këtë një regjistër, me qëllim identifikimin e palëve që kanë përjashtime të veçanta në listat në shtojcat A ose B. Ai nuk do të identifikojë palët që përdorin kushtet në shtojcat A ose B që mund të ushtrohen nga të gjitha palët. Regjistri do të mbahet nga sekretariati dhe do të jetë në dispozicion të publikut.

2. Regjistri do të përfshijë:

a) Një listë të llojeve të përjashtimeve të veçanta të rinxjerra nga shtojcat A dhe B;

b) Një listë të palëve që kanë një përjashtim të veçantë sipas shtojcave A dhe B; dhe

c) Një listë të datave të skadencës për çdo përjashtim të veçantë të regjistruar.

3. Çdo shtet, pasi bëhet palë, me anë të një njoftimi me shkrim në sekretariat, mund të regjistrohet për një ose më shumë lloje të përjashtimeve të veçanta të listës së shtojcave A dhe B.

4. Në qoftë se nuk tregohet një datë më e hershme në regjistër nga një palë, ose bëhet një shtyrje e afatit në pajtim me paragrafin 7, të gjitha regjistrimet e përjashtimeve të veçanta do të skadojnë pesë vjet pas datës së hyrjes në fuqi të kësaj Konvente lidhur me një kimikat të veçantë.

5. Në mbledhjen e saj të parë, konferenca e palëve do të vendosë mbi procesin e rishikimit për hyrjet në regjistër.

6. Para rishikimit të një hyrjeje, pala e interesuar do të dorëzojë një raport në sekretariat për të justifikuar nevojën e vazhdueshme për regjistrimin e atij përjashtimi. Raporti do të qarkullojë nga Sekretariati te të gjitha palët. Rishikimi i një regjistrimi do të kryhet mbi bazën e informacionit në dispozicion. Pas kësaj konferenca e palëve mund të bëjë rekomandime të tilla palëve të interesuara, siç e gjykon të përshtatshme.

7. Konferenca e palëve, me kërkesë të palës së interesuar, mund të vendosë shtyrjen e datës së skadencës së një përjashtimi të veçantë për një periudhë deri në pesë vjet. Në marrjen e vendimit, konferenca e palëve do të marrë parasysh rrethanat specifike të palëve-vende në zhvillim dhe të palëve me ekonomi në tranzicion.

8. Një palë mund të tërheqë në çdo kohë një hyrje nga regjistri për një përjashtim të veçantë pas njoftimit me shkrim të sekretariatit. Tërheqja do të hyjë në fuqi në datën e specifikuar në njoftim.

9. Kur nuk ka më palë të regjistruara për një lloj të veçantë përjashtimi të veçantë nuk mund të bëhen regjistrime të reja në lidhje me të.

E. Planet e zbatimit

1. Çdo palë:

a) do të zhvillojë dhe do të përpiqet të zbatojë një plan për zbatimin e detyrimeve të veta sipas Konventës;

b) do të transmetojë planin e vet të zbatimit në konferencën e palëve brenda dy vjetëve nga data në të cilën kjo Konventë hyn në fuqi për të; dhe

c) do të rishikojë dhe do të përmirësojë, kur është e përshtatshme, planin e zbatimit mbi baza periodike dhe në një mënyrë që të jetë specifike për vendimin e konferencës së palëve.

2. Palët do të bashkëpunojnë drejtpërdrejt ose nëpërmjet organizatave globale, rajonale dhe nënrajonale, kur është e përshtatshme, dhe do të konsultohen me aktorët pjesëmarrës kombëtarë, duke përfshirë grupet e grave dhe grupet e përfshira në shëndetin e fëmijëve, me qëllim që të lehtësohet zhvillimi, zbatimi dhe përmirësimi i planeve të zbatimit të tyre.

3. Palët do të përpqen të shfrytëzojnë dhe, ku është e përshtatshme, të përcaktojnë mjetet për të integruar planet kombëtare të zbatimit për ndotësit organikë, të qëndrueshëm në strategjitë e zhvillimit të qëndrueshëm, kur është e përshtatshme.

F. Lista e kimikateve në shtojcat A, B dhe C

1. Një palë mund të dorëzojë një propozim te sekretariati për futjen e një kimikati në listën e shtojcave A, B dhe/ose C. Propozimi do të përmbajë informacionin e specifikuar në shtojcën D. Në zhvillimin e një propozimi, një palë mund të ndihmohet nga palët e tjera dhe/ose nga sekretariati.

2. Sekretariati do të verifikojë nëse propozimi përmban informacionin e specifikuar në shtojcën D. Në qoftë se sekretariati është i kënaqur që propozimi përmban informacionin e specifikuar, ai do t'ia dorëzojë atë Komitetit të Rishikimit të Ndotësve Organikë të Qëndrueshëm.

3. Komiteti do të shqyrtojë propozimin dhe do të zbatojë kriteret e ndarjes të specifikuar në shtojcën D në një mënyrë fleksibile dhe transparente, duke marrë në konsideratë të gjithë informacionin e dhënë në mënyrë integrale dhe të ekuilibruar.

3 bis. Në qoftë se Komiteti vendos që:

a) janë plotësuar kriteret e ndarjes, nëpërmjet sekretariatit, ta vërë propozimin dhe vlerësimin e Komitetit në dispozicion të të gjitha palëve dhe vëzhguesve dhe do t'i ftojë ata të dorëzojnë informacionin e specifikuar në shtojcën E ose

b) nuk janë plotësuar kriteret e ndarjes, ai, nëpërmjet sekretariatit, do të njoftojë të gjitha palët dhe vëzhguesit dhe do ta vërë propozimin dhe vlerësimin e Komitetit në dispozicion të të gjitha palëve dhe propozimi lihet mënjanë.

3 tër. Çdo palë mund të dorëzojë përsëri te Komiteti një propozim që është lënë mënjanë prej tij në pajtim me paragrafin 3 bis. Ridorëzimi mund të përfshijë çdo shqetësim të palës, si dhe justifikimin për shqyrtim shtesë nga Komiteti. Në qoftë se, duke ndjekur këtë procedurë, Komiteti përsëri e lë mënjanë këtë propozim, pala mund të sfidojë vendimin e Komitetit dhe konferenca e palëve do të shqyrtojë çështjen në sesionin tjetër të saj. Konferenca e palëve mund të vendosë, bazuar në kriteret e ndarjes në shtojcën D, dhe të marrë parasysh vlerësimin e Komitetit dhe çdo informacion tjetër të dhënë nga çdo palë ose vëzhgues, që propozimi duhet të vazhdojë.

4. Kur Komiteti ka vendosur që kriteret e ndarjes janë plotësuar ose konferenca e palëve ka vendosur që propozimi duhet të vazhdojë, Komiteti do të shqyrtojë më tej propozimin, duke marrë parasysh çdo informacion tjetër të marrë dhe do të përgatisë një projektprofil të rrezikut në përputhje me shtojcën E. Ai, nëpërmjet sekretariatit, do ta vërë draftin në dispozicion të të gjitha palëve dhe vëzhguesve, do të grumbullojë komentet teknike prej tyre dhe, duke marrë parasysh ato komente, do të plotësojë profilin e rrezikut.

5. Në qoftë se, mbi bazën e profilit të rrezikut të kryer në përputhje me shtojcën E, Komiteti vendos që:

a) kimikati ka mundësi që, si rezultat i transportit në hapësira të mëdha mjedisore, të çojë në efekte mjaft të dëmshme për shëndetin e njeriut dhe mjedisin sa që justifikon veprimin global, kështu që propozimi do të veprojë. Mungesa e qartësisë së plotë shkencore nuk do të pengojë që propozimi të veprojë. Komiteti, nëpërmjet sekretariatit, do të kërkojë informacion nga të gjitha palët dhe vëzhguesit lidhur me konsideratat që specifikohen në shtojcën F. Pastaj ai do të përgatisë një vlerësim të administrimit të rrezikut që përfshin analizën e masave të mundshme të kontrollit për kimikatin në përputhje me atë shtojcë; ose

b) nëse propozimi nuk do të veprojë, ai, nëpërmjet sekretariatit, do të vërë profilin e rrezikut në dispozicion të të gjitha palëve dhe vëzhguesve dhe e lë propozimin mënjanë.

6 bis. Për çdo propozim të lënë mënjanë në pajtim me paragrafm 6, një palë mund të kërkojë që konferenca e palëve të konsiderojë udhëzimin e Komitetit për të kërkuar informacion shtesë nga pala propozuese dhe palët e tjera gjatë një periudhe që të mos e kalojë vitin. Pas asaj periudhe dhe mbi bazën e çdo informacioni të marrë, Komiteti do të rikonsiderojë propozimin në pajtim me paragrafin 4 për t'u vendosur me përparësi nga konferenca e palëve. Në qoftë se, duke ndjekur këtë procedurë, Komiteti përsëri e lë mënjanë propozimin, pala mund ta sfidojë vendimin e Komitetit dhe konferenca e palëve do të konsiderojë çështjen në sesionin tjetër. Konferenca e palëve mund të vendosë, bazuar në profilin e rrezikut të përgatitur në pajtim me shtojcën E dhe duke marrë parasysh vlerësimin e Komitetit dhe çdo informacion tjetër të dhënë nga çdo palë ose vëzhgues, që propozimi duhet të vazhdojë. Në qoftë se konferenca e palëve do të vendosë që propozimi do të vazhdojë, Komiteti atëherë do të përgatisë një vlerësim të administrimit të rrezikut.

7. Komiteti, bazuar në profilin e rrezikut të referuar në paragrafin 4 dhe vlerësimin e profilit të rrezikut të referuar në paragrafin 5, do të rekomandojë nëse kimikati do të konsiderohet nga konferenca e palëve për t'u futur në listën e shtojcave A, B dhe/ose D. Konferenca e palëve, duke marrë parasysh rekomandimet e Komitetit, duke përfshirë çdo pasiguri shkencore, do të vendosë, në mënyrë parandaluese, nëse të futet në listë kimikati dhe do të specifikojë masat e kontrollit që lidhen me të, në shtojcat A, B dhe/ose C.

G. Shkëmbimi i informacionit

1. Çdo palë do të lehtësojë ose ndërmarrë shkëmbimin e informacionit përkatës për:

a) reduktimin ose eliminimin e prodhimit, përdorimit dhe shkarkimit të ndotësve organikë të qëndrueshëm dhe

b) alternativat e ndotësve organikë të qëndrueshëm, duke përfshirë informacionin lidhur me rreziqet e tyre, si dhe me kostot e tyre ekonomike dhe sociale.

2. Palët do të shkëmbejnë informacionin e referuar në paragrafin 1, drejtpërdrejt ose nëpërmjet sekretariatit.

3. Çdo palë do të caktojë pikat qendrore kombëtare për shkëmbimin e informacionit të tillë.

4. Sekretariati do të shërbejë si mekanizëm rregullues për informacionin mbi ndotësit organikë të qëndrueshëm, duke përfshirë informacionin e siguruar nga palët, organizatat ndërqeveritare dhe organizatat joqeveritare.

5. Për qëllime të kësaj Konvente, informacioni mbi shëndetin dhe sigurinë e njerëzve dhe mjedisit nuk do të konsiderohet si konfidencial. Palët që shkëmbejnë informacione të tjera në pajtim me këtë Konventë do të ruajnë çdo informacion konfidencial, siç bien dakord midis tyre.

H. Informimi, ndërgjegjësimi dhe edukimi i publikut

1. Çdo palë, brenda kapaciteteve të veta, do të nxisë dhe ndihmojë:

a) ndërgjegjësimin midis politikanëve dhe vendimmarrësve të vet lidhur me ndotësit organikë të qëndrueshëm;

b) dhënien e publikut të gjithë informacionit në dispozicion mbi ndotësit organikë të qëndrueshëm, duke marrë parasysh paragrafin 5 të nenit G;

c) zhvillimin dhe zbatimin, veçanërisht për gratë, fëmijët dhe të paarsimuarit, të programeve për ndërgjegjësimin publik dhe të edukimit mbi ndotësit organikë të qëndrueshëm, si dhe mbi efektet e tyre për shëndetin dhe mjedisin dhe mbi alternativat e tyre.

d) pjesëmarrjen e publikut në adresimin ndaj ndotësve organikë të qëndrueshëm dhe efektet e tyre për shëndetin dhe mjedisin dhe në zhvillimin e përgjigjeve të përshtatshme, duke përfshirë mundësitë për sigurimin e inputeve në nivel kombëtar lidhur me zbatimin e kësaj Konvente;

(e) trajnimin e punëtorëve, shkencëtarëve, edukatorëve dhe personelit teknik e drejtues;

(f) zhvillimin dhe shkëmbimin e materialeve edukative të ndërgjegjësitimit publik në nivelet kombëtare dhe ndërkombëtare;

g) zhvillimin dhe zbatimin e programeve të edukimit dhe trajnimit në nivelet kombëtare dhe ndërkombëtare.

2. Çdo palë, brenda kapaciteteve të veta, do të sigurojë që publiku të ketë mundësi për të marrë informacionin publik referuar në paragrafin 1 dhe që informacioni të jetë i kohëve të fundit.

3. Çdo palë, brenda kapaciteteve të veta, do të inkurajojë industrinë dhe përdoruesit profesionistë të nxisin dhe të ndihmojnë sigurimin e informacionit referuar në paragrafin 1 në nivel kombëtar dhe, si të jetë e përshtatshme, në nivelet nënrajonale, rajonale dhe globale.

4. Në sigurimin e informacionit mbi ndotësit organikë të qëndrueshëm dhe alternativat e tyre, palët mund të përdorin fletë me të dhëna siguri, raporte, masmedian dhe mjete të tjera të komunikimit dhe mund të ngrenë qendra informimi në nivelet rajonale dhe kombëtare.

5. Çdo palë duhet të japë konsiderata ndaj mekanizmave të zhvillimit, si p.sh. regjistrat e shkarkimit dhe transferimit të ndotësve, për grumbullimin dhe shpërndarjen e informacionit mbi vlerësimet e sasive të kimikateve të listës në shtojcat A, B ose C që çlirohen ose shkatërrohen.

I. Kërkimet, zhvillimi dhe monitorimi

Palët, brenda kapaciteteve të tyre, në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar, do të inkurajojnë dhe ndërmarrin kërkimet përkatëse, zhvillimin, monitorimin dhe bashkëpunimin lidhur me ndotësit organikë të qëndrueshëm, alternativat e tyre dhe lidhur me ndotësit organikë të qëndrueshëm të ardhshëm, të përfshirë në:

a) burimet dhe shkarkimet e tyre në mjedis;

b) prezenca, nivelet dhe tendencat te njerëzit dhe në mjedis;
c) transportin në mjedis, fatin dhe transformimin;
d) efektet mbi shëndetin e njerëzve dhe mjedisin;
e) ndikimet social-ekonomike dhe kulturore;
f) reduktimin e shkarkimit dhe/ose eliminimin;
g) metodologjitë e harmonizuara për bërjen e inventareve të burimeve gjeneruese dhe teknikat analitike për matjen e ndotësve të çliruar.

2. Në ndërmarrjen e veprimit sipas paragrafit 1, palët, brenda kapaciteteve të tyre:

a) do të mbështesin dhe zhvillojnë më tej programet, rrjetet dhe organizatat ndërkombëtare me qëllim përcaktimin, kryerjen, vlerësimin dhe financimin e kërkimeve, grumbullimin e të dhënave dhe monitorimin, duke marrë parasysh nevojën për të minimizuar dublimin e përpjekjes;

b) do të mbështesin përpjekjet kombëtare dhe ndërkombëtare për të forcuar aftësitë kombëtare të kërkimeve shkencore dhe teknike, veçanërisht në vendet në zhvillim dhe vendet me ekonomi në tranzicion dhe të nxisë futjen dhe shkëmbimin e të dhënave dhe analize;

c) do të marrin parasysh shqetësimet dhe nevojat, veçanërisht në fushën e burimeve financiare dhe teknike të vendeve në zhvillim dhe vendeve me ekonomi në tranzicion dhe do të bashkëpunojë në përmirësimin e kapaciteteve të tyre për të marrë pjesë në përpjekje referuar në nënparagrafët (a) dhe (b);

d) do të ndërmarrin punë kërkimore të përshtatshme për të lehtësuar efektet e ndotësve organik të qëndrueshëm mbi shëndetin riprodhues;

e) do të bëjnë që rezultatet e aktiviteteve të tyre kërkimore, të zhvillimit dhe të monitorimit referuar në këtë paragraf të jenë të hapura për publikun në kohën e duhur dhe në mënyrë të rregullt;

f) do të inkurajojnë dhe të ndërmarrin bashkëpunimin lidhur me magazinimin dhe ruajtjen e informacionit të nxjerrë nga kërkimet, zhvillimi dhe monitorimi.

J. Asistenca teknike

1. Palët e dinë që dhënia e asistencës përkatëse dhe në kohën e duhur, në përgjigje të kërkesave nga palët-vende në zhvillim dhe ato me ekonomi në tranzicion, është thelbësore për zbatimin e suksesshëm të kësaj Konvente.

2. Palët do të bashkëpunojnë për të siguruar asistencën përkatëse dhe në kohën e duhur për palët-vende në zhvillim dhe për ato me ekonomi në tranzicion, për t'i ndihmuar ato, duke marrë parasysh nevojat e tyre të veçanta, për të zhvilluar dhe forcuar kapacitetin e tyre për zbatimin e detyrimeve sipas kësaj Konvente.

3. Lidhur me këtë asistenca teknike që duhet të jepet nga palët-vende të zhvilluara dhe palët e tjera në përputhje me kapacitetet e tyre, do të përfshijë, si të jetë e përshtatshme dhe si të kenë rënë dakord reciprokisht, asistencë teknike për ndërtimin e kapacitetit lidhur me zbatimin e detyrimeve sipas kësaj Konvente. Udhëzime të tjera, në këtë aspekt, do të sigurohen nga konferenca e palëve.

4. Palët do të bëjnë marrëveshje, përkatësisht, për sigurimin e asistencës teknike dhe nxitjen e transferimit të teknologjisë te palët-vende në zhvillim dhe në ato me ekonomi në tranzicion lidhur me zbatimin e kësaj Konvente. Këto marrëveshje do të përfshijnë qendrat rajonale dhe nënrajonale për ndërtimin e kapacitetit dhe për transferimin e teknologjisë për të ndihmuar palët-vende në zhvillim dhe palët me ekonomi në tranzicion të përmbushin detyrimet sipas kësaj Konvente. Udhëzime të tjera, në këtë aspekt, do të sigurohen nga konferenca e palëve.

5. Palët, në kontekstin e këtij neni, do të marrin parasysh plotësisht nevojat specifike dhe situatën e veçantë të vendeve më pak të zhvilluara dhe të shteteve ishuj të vegjël e në zhvillim në veprimet e tyre lidhur me asistencën teknike.

K. Burimet dhe mekanizmat financiarë

1. Çdo palë merr përsipër të sigurojë, brenda kapaciteteve të saj, mbështesë dhe shtytësa financiarë në lidhje me ato aktivitete kombëtare që synojnë të arrijnë objektivin e kësaj Konvente në përputhje me planet, përparësitë dhe programet kombëtare.

2. Palët-vende të zhvilluara do të sigurojnë burime financiare të reja shtesë për të mundësuar palët-vende në zhvillim dhe ato me ekonomi në tranzicion të paguajnë kostot e shumta plotësisht të pranuar të zbatimit të masave të cilat përmbushin detyrimet e tyre sipas kësaj Konvente, të miratuara ndërmjet një pale marrëse dhe një entiteti pjesëmarrës në mekanizmat e përshkuar në paragrafin 6. Palët e tjera mund të sigurojnë gjithashtu mbi bazë vullnetare dhe në përputhje me kapacitetet e tyre

burime të tilla financiare. Kontributet nga burime të tjera duhet të inkurajohen gjithashtu. Zbatimi i këtyre angazhimeve do të marrë parasysh nevojën për përshtatshmëri, parashikim, rrjedhën në kohën e duhur të fondeve dhe rëndësinë e ndarjes së barrës midis Palëve kontribuese.

3. Palët-vende të zhvilluara dhe palët e tjera, në përputhje me kapacitetet e tyre dhe me planet, përparësitë dhe programet kombëtare të tyre, mund gjithashtu të sigurojnë burime financiare dhe palët-vende në zhvillim dhe atë me ekonomi në tranzicion mund të përfitojnë prej tyre për të ndihmuar zbatimin e kësaj Konvente nëpërmjet burimeve ose kanaleve të tjera dypalëshe, rajonale dhe shumëpalëshe.

4. Shkalla në të cilën palët-vende në zhvillim do të zbatojnë me efektivitet angazhimet e tyre sipas kësaj Konvente, do të varet nga zbatimi efektiv nga palët-vende të zhvilluara i angazhimeve të tyre sipas kësaj Konvente lidhur me burimet financiare, asistencën teknike dhe transferimin e teknologjisë. Fakti që zhvillimi i pandërprerë ekonomik dhe social dhe eliminimi i varfërisë janë përparësitë e para të palëve-vende në zhvillim, do të merren krejtësisht parasysh, duke i dhënë konsideratën e duhur nevojës për mbrojtjen e shëndetit të njerëzve dhe mjedisit.

5. Palët do të marrin plotësisht parasysh nevojat specifike dhe situatën e veçantë të vendeve më pak të zhvilluara dhe shteteve ishuj të vegjël në veprimet e tyre lidhur me financimet.

6. Për këtë është përcaktuar një mekanizëm për sigurimin e burimeve financiare të mjaftueshme dhe të pandërprera për palët-vende në zhvillim dhe ato me ekonomi në tranzicion mbi bazë granti ose koncesioni për të ndihmuar zbatimin e Konventës. Mekanizmi do të funksionojë, përkatësisht, nën autoritetin e konferencës së palëve, do të drejtohet dhe do të japë llogari atje për qëllime të kësaj Konvente. Funksionimi i tij do t'i besohet një ose më shumë entiteteve, duke përfshirë entitetet ndërkombëtare ekzistuese, siç mund të vendoset nga konferenca e palëve. Mekanizmi mund të përfshijë gjithashtu entitete të tjera që japin asistencë shumëpalëshe, rajonale dhe dypalëshe. Kontributet për mekanizmin do të jenë transfertat financiare shtesë për palët-vende në zhvillim dhe ato me ekonomi në tranzicion, siç reflektohet dhe në përputhje me paragrafin 2.

7. Në pajtim me objektivat e kësaj Konvente dhe paragrafin 6, konferenca e palëve, në mbledhjen e saj të parë, do të adoptojë udhëzuesin përkatës që duhet t'i sigurohet mekanizmit dhe do të bjerë dakord me entitetin ose entitetet pjesëmarrëse në mekanizmin financiar mbi marrëveshjet për funksionimin. Udhëzuesi do të përfshijë, *inter alia*:

a) përcaktimin e politikave, strategjive dhe përparësive të programeve, si dhe kriteret dhe direktivat e qarta dhe të hollësishme lidhur me përshtatshmërinë për të hyrë dhe shfrytëzuar burimet financiare duke përfshirë monitorimin dhe vlerësimin mbi baza të rregullta të një shfrytëzimi të tillë;

b) dhënien e raporteve nga entiteti ose entitetet në konferencën e Palëve mbi mjaftueshmërinë dhe vazhdimësinë e fondeve për aktivitetet që kanë të bëjnë me zbatimin e kësaj Konvente;

c) nxitjen e metodave, mekanizmave dhe marrëveshjeve të financimit nga shumë burime;

d) modalitetet për përcaktimin në mënyrë të parashikueshme dhe të identifikueshme të sasisë së fondeve të nevojshme dhe në dispozicion për zbatimin e kësaj Konvente, duke mos harruar se ndarja në faza e ndotësve organikë të qëndrueshëm mund të kërkojë financim të pandërprerë dhe kushtet në të cilat ajo sasi duhet rishikuar në mënyrë periodike;

e) modalitetet për sigurimin e asistencës për palët e interesuara me vlerësimin e nevojave, informacionin mbi burimet e mundshme të fondeve dhe mbi modelet e financimit për të lehtësuar bashkërendimin midis tyre.

8. Konferenca e palëve do të shqyrtojë, jo më vonë se në mbledhjen e saj të dytë dhe pas kësaj në mënyrë të rregullt, efektshmërinë e mekanizmit të krijuar sipas këtij neni, aftësinë e tij për t'iu drejtuar nevojave në ndryshim të palëve-vende në zhvillim dhe atyre me ekonomi në tranzicion, kriteret dhe udhëzuesin e referuar në paragrafin 7, nivelin e financimit, si dhe efektivitetin e punës së entiteteve institucionale, të besuara për të vënë në funksionim mekanizmin financiar. Bazuar në këtë shqyrtim, ajo do të marrë veprimin përkatës, në qoftë se është i nevojshëm, për të përmirësuar efektshmërinë e mekanizmit, duke përfshirë mjetet e rekomandimit dhe udhëzimin mbi masat për të siguruar financimin e mjaftueshëm dhe të vazhdueshëm për të plotësuar nevojat e palëve.

K bis. Marrëveshjet financiare të përkohshme

Struktura institucionale e Facilitetit të Mjedisit Global, që vepron në përputhje me instrumentin për krijimin e Facilitetit të Mjedisit Global të Ristrukturuar, mbi bazë të përkohshme, do të jetë entiteti kryesor i besuar për funksionimin e mekanizmit financiar referuar në nenin K, për periudhën ndërmjet datës së hyrjes në fuqi të kësaj Konvente dhe mbledhjes së parë të konferencës së

palëve, ose deri në kohën që konferenca e palëve të vendosë se cila strukturë institucionale do të caktohet në përputhje me nenin K. Struktura institucionale e Fasilitetit të Mjedisit Global duhet të plotësojë këtë funksion përmes masave operative që lidhen në mënyrë specifike me ndotësit organikë të qëndrueshëm, duke marrë parasysh se mund të nevojiten marrëveshje të reja në këtë fushë.

L. Raportimi

1. Çdo palë do të raportojë në konferencën e palëve mbi masat që ka marrë për të zbatuar kushtet e kësaj Konvente dhe mbi efektshmërinë e masave të tilla në plotësimin e objektivave të Konventës.

2. Çdo palë do t'i sigurojë sekretariatit:

a) të dhëna statistikore mbi sasitë e përgjithshme të prodhimit, importit dhe eksportit të çdo kimikati të listës në shtojcën A dhe B ose një vlerësim të arsyeshëm të të dhënave të tilla:

b) deri në një shkallë të praktikueshme, një listë të shteteve nga të cilat importohet çdo substancë e tillë dhe të shteteve të cilat ai ka eksportuar çdo substancë të tillë.

3. Raportime të tilla do të jenë në intervale periodike dhe në një format që duhet vendosur nga konferenca e palëve në mbledhjen e saj të parë.

L bis. Vlerësimi i efektshmërisë

1. Duke filluar katër vjet pas datës së hyrjes në fuqi të kësaj Konvente dhe periodikisht pas kësaj në intervale që duhet të vendosen nga konferenca e palëve, konferenca do të vlerësojë efektshmërinë e Konventës.

2. Për të ndihmuar një vlerësim të tillë, konferenca e palëve, në mbledhjen e saj të parë, do të iniciojë përcaktimin e marrëveshjes për t'i siguruar vetes të dhëna monitorimi të krahasueshme mbi prezencën e kimikateve të listës në shtojcën A, B dhe C, si dhe transporti i tyre në mjedisin rajonal dhe global. Këto marrëveshje:

a) duhet të zbatohen nga palët mbi baza rajonale kur është e përshtatshme, në përputhje me kapacitetet e tyre teknike dhe financiare, duke përdorur programet dhe mekanizmat ekzistuese të monitorimit në shkallë të mundshme dhe nxitjen e harmonizimit të metodave;

b) mund të plotësohen kur është e nevojshme, duke marrë parasysh diferencat midis rajoneve dhe aftësive të tyre për të zbatuar aktivitetet e monitorimit;

c) do të përfshijnë raportet në konferencën e palëve mbi rezultatet e aktiviteteve të monitorimit mbi baza rajonale dhe globale në intervale që duhen specifikuar nga konferenca e palëve.

3. Vlerësimi i përshkruar në paragrafin 1 do të kryhet mbi bazën e informacionit shkencor, mjedisor, teknik dhe ekonomik në dispozicion, duke përfshirë:

a) raportet dhe informacione të tjera monitorimi të siguruar në pajtim me paragrafin 2;

b) raportet kombëtare të dorëzuara në pajtim me nenin L; dhe

c) informacionin që sigurohet në pajtim me procedurat e përcaktuara në nenin M.

M. Mospërputhja

Konferenca e palëve do të zhvillojë dhe miratojë, sa më praktike që të jetë e mundur procedurat dhe mekanizmat institucionale për përcaktimin e mospërputhjes me kushtet e kësaj Konvente dhe për trajtimin e palëve që gjenden se janë në kundërvajtje (mospërputhje).

N. Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

1. Palët do të zgjidhin çdo mosmarrëveshje ndërmjet tyre përsa i përket interpretimit ose zbatimit të kësaj Konvente përmes bisedimeve ose mjeteve të tjera paqësore që ato zgjedhin.

2. Kur ratifikojnë, pranojnë, miratojnë ose hyjnë në Konventë, ose në çdo kohë pas kësaj, një palë, që nuk është organizatë rajonale e integritit ekonomik, mund të deklarojë në një instrument me shkrim të dorëzuar në vendin e depozitimit se, përsa i përket çdo mosmarrëveshjeje që ka të bëjë me interpretimin ose zbatimin e Konventës, ajo njih një ose të dyja mjetet e mëposhtme të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve si të detyrueshme në lidhje me çdo palë që pranon të njëjtin detyrim:

a) Arbitrazhi në përputhje me procedurat që duhet të adoptohet nga konferenca e palëve në një shtojcë sa më shpejt që të jetë praktikueshme;

b) Dorëzimi i mosmarrëveshjes te Gjykata e Lartë Ndërkombëtare.

3. Një Palë që është organizatë rajonale e integritit ekonomik, mund të bëjë një deklaratë me të njëjtin efekt lidhur me arbitrazhin në përputhje me procedurat e referuara në paragrafin 2 (a).

4. Një deklaratë e bërë në pajtim me paragrafin 2 ose paragrafin 3 do të mbetet në fuqi derisa të skadojë në përputhje me afatet e saj ose tre muaj pas njoftimit me shkrim të revokimit të saj që është

depozituar te vendi i depozitimit.

5. Skadimi i një deklarate, një njoftimi për revokim ose një deklarate të re nuk do të ndikojë në asnjë mënyrë procedurat e pazgjidhura para një gjyqi për arbitrazh ose Gjykatës Ndërkombëtare në qoftë se palët në mosmarrëveshje nuk bien dakord ndryshe.

6. Në qoftë se palët në një mosmarrëveshje nuk kanë pranuar të njëjtën ose çdo procedurë në pajtim me paragrafin 2 dhe në qoftë se ato nuk mund të zgjidhin mosmarrëveshjen e tyre brenda 12 muajve pas njoftimit nga njëra palë te tjetra se ekziston një mosmarrëveshje midis tyre, mosmarrëveshja do të dorëzohet te komisioni i pajtimit me kërkesë të çdo pale në mosmarrëveshje. Komisioni i pajtimit do të japë një raport me rekomandime. Procedurat e tjera lidhur me komisionin e pajtimit do të përfshihen në një shtojcë që duhet të adoptohet nga konferenca e palëve jo më vonë se në mbledhjen e dytë.

O. Konferenca e palëve

1. Për këtë krijohet Konferenca e palëve.

2. Mbledhja e parë e konferencës së palëve do të mbledhet nga Drejtori Ekzekutiv i Programit të Kombeve të Bashkuara për Mjedisin jo më vonë se një vit pas hyrjes në fuqi të kësaj Konvente. Pas kësaj, mbledhjet e zakonshme të konferencës së palëve do të bëhen në intervale kohore të rregullta që do të vendosen nga Konferenca.

3. Mbledhjet e jashtëzakonshme të konferencës së palëve do të mbahen në çdo kohë tjetër që mund të gjykohet e nevojshme nga Konferenca, ose me një kërkesë me shkrim nga çdo Palë, me kusht që ajo të mbështetet nga të paktën një e treta e palëve.

4. Konferenca e palëve do të miratojë dhe adoptojë me konsensus në mbledhjen e saj të parë mbi rregullat e procedurës dhe rregullat financiare për vete dhe për çdo organ ndihmës, si dhe kushtet financiare që rregullojnë funksionimin e sekretariatit.

5. Konferenca e palëve do të mbajë nën shqyrtim dhe vlerësim të vazhdueshëm zbatimin e kësaj Konvente. Ajo do të kryejë funksionet që i janë caktuar asaj nga Konventa dhe për këtë qëllim:

a) do të krijojë, përtej kërkesave të paragrafit 6, organe ndihmëse të tilla si të mendohet e nevojshme për zbatimin e Konventës;

b) do të bashkëpunojë, përkatësisht, me organizata ndërkombëtare kompetente dhe organe ndërqeveritare dhe joqeveritare; dhe

b) do të bis bashkëpunojë, përkatësisht, rregullisht të gjithë informacionin e vënë në dispozicion të Palëve në pajtim me nenin L, duke përfshirë gjykimin e efektshmërisë të 1 bis (iii) të nenit D;

c) do të konsiderojë dhe do të marrë përsipër çdo verifikim plotësues që mund të kërkohet për realizimin e objektivave të Konventës.

6. Konferenca e Palëve, në mbledhjen e saj të parë, do të krijojë organin ndihmës që do të quhet Komiteti i Shqyrtimit të Ndotësve Organikë të Qëndrueshëm, i cili do të kryejë funksionet e caktuara atij Komiteti nga kjo Konventë. Për këtë:

a) anëtarët e Komitetit të Shqyrtimit të Ndotësve Organikë të Qëndrueshëm do të caktohen nga Konferenca e Palëve. Anëtarësia e Komitetit do të përbëhet nga ekspertë të caktuar nga qeveria në vlerësimin dhe administrimin e kimikateve. Anëtarët e Komitetit do të caktohen mbi bazën e shpërndarjes së barabartë gjeografike;

b) konferenca e palëve do të vendosë mbi kushtet e referimit, organizimin dhe funksionimin e Komitetit;

c) Komiteti do të bëjë çdo përpjekje për të adoptuar rekomandimet e tij me konsensus. Në qoftë se të gjitha përpjekjet me konsensus janë ezauruar dhe nuk arrihet konsensusi, rekomandimi i tillë do të adoptohet si mjet i fundit nga një shumicë vote prej dy të tretave të anëtarëve prezentë në votim.

7. Konferenca e palëve, në mbledhjen e saj të parë, do të vlerësojë nevojën e vazhdueshme për procedurën që përmban nënparagrafi 1 bis(b) i nenit D, duke përfshirë konsideratat e efektshmërisë së vet.

8. Kombet e Bashkuara, agjencitë e specializuara të tyre dhe Agjencia Ndërkombëtare e Energjisë Atomike, si dhe çdo shtet jo palë në këtë Konventë, mund të paraqiten në mbledhjet e konferencës së palëve si vëzhgues. Çdo organ ose agjenci, qoftë kombëtare ose ndërkombëtare, qeveritare ose joqeveritare, e kualifikuar në çështje që mbulohen në Konventë dhe që kanë informuar sekretariatit për dëshirën e saj të paraqitet në mbledhjen e konferencës së palëve si një vëzhgues,

mund të pranohet në qoftë se nuk kundërshton të paktën një e treta e palëve të pranishme. Pranimi dhe pjesëmarrja e vëzhguesve do t'i nënshtrohet rregullave të procedurës të adoptuara nga konferenca e palëve.

P. Sekretariati

1. Për këtë krijohet sekretariati.
2. Funkcionet e sekretariatit do të jenë:
 - a) të bëjë marrëveshjet për mbledhjet e konferencës së palëve dhe të organeve ndihmëse dhe t'u sigurojë atyre shërbimet e kërkuara;
 - b) të lehtësojë asistencën për palët, veçanërisht palët-vende në zhvillim dhe ato me ekonomi në tranzicion, sipas kërkesës, për zbatimin e kësaj Konvente;
 - c) të sigurojë bashkërendimin e nevojshëm me sekretariatet e organeve të reja ndërkombëtare që kanë lidhje me të;
 - d) të përgatisë dhe të vërë në dispozicion të Palëve raportet periodike bazuar në informacionin e marrë në pajtim me nenin L dhe informacione të tjera në dispozicion;
 - e) të hyjë, sipas udhëzimeve të përgjithshme të Konferencës së Palëve, në marrëveshje administrative dhe kontraktuale siç mund të kërkohej për kryerjen me efektivitet të funksioneve të tij;
 - f) Të kryejë funksione të tjera të sekretariatit të specifikuar në këtë Konventë dhe funksione të tjera siç përcaktohen nga konferenca e palëve.
3. Funkcionet e sekretariatit për këtë Konventë do të kryhen nga Drejtori Ekzekutiv i Programit të Kombeve të Bashkuara për Mjedisin, në qoftë se konferenca e palëve nuk vendos, me dy të tretat e shumicës së Palëve presente në votim, për t'ia besuar funksionet e Sekretariatit një ose më shumë organizatave të tjera ndërkombëtare.

Q. Amendamentet e Konventës

1. Amendamentet e Konventës mund të propozohen nga çdo palë.
2. Amendamentet e Konventës do të adoptohen në mbledhjen e konferencës së palëve. Teksti i çdo amendamenti të propozuar do t'i komunikohet Palëve nga sekretariati të paktën 6 muaj para mbledhjes në të cilën ai propozohet për adoptim. Sekretariati do të komunikojë gjithashtu amendamentet e propozuara nënshkruesve të kësaj Konvente dhe, për informacion, vendit të depozitimit.
3. Palët do të bëjnë çdo përpjekje për të arritur marrëveshjen mbi çdo amendament të propozuar të kësaj Konvente me konsensus. Në qoftë se përpjekjet për konsensus janë ezauruar dhe asnjë marrëveshje nuk është arritur, amendamenti do të adoptohet, si mjet i fundit, me 2/3 e votës së shumicës së palëve të pranishme në votim.
4. Amendamentet do t'u komunikohen nga vendi i depozitimit të gjitha Palëve për ratifikim, pranim ose aprovim.
5. Ratifikimi, pranimi ose aprovimi i një amendamenti do të njoftohet nga vendi i depozitimit me shkrim. Një amendament i adoptuar në përputhje me paragrafin 3 do të hyjë në fuqi për Palët që e kanë pranuar atë në ditën e 19-të pas datës së depozitimit të instrumentit të ratifikimit, pranimit ose aprovimit nga të paktën 2/3 e palëve. Pas kësaj, amendamenti do të hyjë në fuqi për çdo palë tjetër në ditën e 19-të pas datës në të cilën ajo palë depoziton instrumentin e vet të ratifikimit, pranimit ose aprovimit të amendamentit.

R. Adoptimi dhe amendimi i shtojcave

1. Shtojcat në këtë Konventë do të formojnë një pjesë përbërëse dhe, në qoftë se shprehimisht nuk parashikohet ndryshe, një referencë për këtë Konventë përbën në të njëjtën kohë një referencë për çdo shtojcë këtu.
2. Çdo shtojcë tjetër do të kufizohet në çështjet procedurale, shkencore, teknike dhe administrative.
3. Procedura e mëposhtme do të përdoret për propozimin, për adoptimin dhe për hyrjen në fuqi të shtojcave të tjera të kësaj Konvente:
 - a) Shtojcat e tjera do të propozohen dhe adoptohen sipas procedurës së vendosur në paragrafin 1, 2 dhe 3 të nenit Q;
 - b) Çdo palë që nuk është në gjendje të pranojë një shtojcë tjetër, do të njoftojë vendin e depozitimit me shkrim, brenda një viti nga data e komunikimit të adoptimit të shtojcës tjetër nga vendi i depozitimit. Vendi i depozitimit mund të njoftojë pa vonesë palët për çdo njoftim të marrë. Një palë mund të tërheqë në çdo kohë një njoftim të mëparshëm të mospranimit lidhur me çdo shtojcë tjetër dhe

shtojca për pasojë hyn në fuqi për atë palë sipas nënparagrafit (C); dhe

c) Në mbarim të një viti nga data e komunikimit të adoptimit të një shtojce nga vendi i depozitimit, shtojca do të hyjë në fuqi për të gjitha palët që nuk kanë dorëzuar njoftim në përputhje me nënparagrafin (b).

4. Propozimi, adoptimi dhe hyrja në fuqi e amendamenteve të shtojcave A, B dhe C do t'u nënshtrohet të njëjtave procedura si për propozimin, adoptimin dhe hyrjen në fuqi të shtojcave të tjera të kësaj Konvente, me përjashtim që një amendament i Shtojcave A, B dhe C nuk do të hyjë në fuqi lidhur me çdo palë që ka bërë një deklaratë përsa i përket amendimit të këtyre shtojcave në përputhje me nenin U dhe në këtë rast çdo amendament i tillë do të hyjë në fuqi për çdo palë ditën e 19-të pas datës së depozitimit të instrumentit të ratifikimit, të pranimit, të aprovimit ose të hyrjes në fuqi të një amendamenti të tillë.

5. Procedura e mëposhtme do të përdoret për propozimin, adoptimin dhe hyrjen në fuqi të një amendamenti të shtojces D, E ose F:

a) Amendamentet do të propozohen në përputhje me procedurën në paragrafin 1 dhe 2 të nenit Q;

b) Palët do të marrin vendime për një amendament të shtojcave D, E ose F me konsensus; dhe

c) Një vendim për të amenduar shtojcat D, E ose F do t'u komunikohet pa vonesë palëve nga vendi i depozitimit. Amendamenti do të hyjë në fuqi për të gjitha palët në datën e specifikuar në vendim.

6. Në qoftë se një shtojcë ose amendament i një shtojce lidhet me një amendament të kësaj Konvente, shtojca ose amendamenti tjetër nuk do të hyjnë në fuqi deri në kohën që amendamenti i Konventës të hyjë në fuqi.

S. E drejta për të votuar

1. Çdo palë në këtë Konventë do të ketë të drejtën e një vote, me përjashtim të parashikimit në paragrafin 2.

2. Një organizatë rajonale e integritit ekonomik, për çështjet brenda kompetencave të saj, do të ushtrojë të drejtën e saj të votës me një numër votash të barabartë me numrin e shteteve anëtare që janë Palë në këtë Konventë. Një organizatë e tillë nuk do të ushtrojë të drejtën e saj të votës në qoftë se çdo njeri nga shtetet anëtare ushtron të drejtën e votës dhe anasjelltas.

Kjo Konventë do të hapet për firmë në Stokholm nga të gjitha shtetet dhe organizatat rajonale të integritit ekonomik më 23 maj 2001 dhe në selinë e Kombeve të Bashkuara në Nju-Jork nga 24 maj 2001 deri në 22 maj 2002.

U. Ratifikimi, pranimi, aprovimi dhe hyrja në fuqi

1. Konventa do t'i nënshtrohet ratifikimit, pranimit ose aprovimit nga shtetet dhe organizatat rajonale të integritit ekonomik. Ajo do të jetë e hapur për pranimin nga shtetet dhe organizatat rajonale të integritit ekonomik nga dita pas datës në të cilën Konventa mbyllet për nënshkrim. Instrumentet e ratifikimit, e pranimit, e aprovimit ose e hyrjes në fuqi do të depozitohen te vendi i depozitimit.

2. Çdo organizatë rajonale e integritit ekonomik që bëhet palë në këtë Konventë, kur asnjë nga shtetet anëtare të saj nuk është palë, do t'u përmbahet të gjitha detyrimeve sipas kësaj Konvente. Në rastin e organizatave të tilla, një ose më shumë anëtarë të së cilës është palë në këtë Konventë, organizata dhe shtetet anëtare të saj do të vendosin për përgjegjësitë respektive të tyre për kryerjen e detyrimeve të tyre sipas Konventës. Në raste të tilla, organizata dhe shtetet anëtare nuk do të kenë të drejtë të ushtrojnë të drejtat e tyre njëkohësisht.

3. Në instrumentet e saj të ratifikimit, të pranimit, të aprovimit dhe të hyrjes në fuqi, një organizatë rajonale e integritit ekonomik do të deklarojë shkallën e kompetencës lidhur me çështjet që rregullohen në këtë Konventë. Çdo organizatë e tillë do të informojë gjithashtu vendin e depozitimit, i cili nga ana e tij do të informojë palët për çdo modifikim përkatës në shkallën e kompetencës së vet.

4. Në instrumentet e saj të ratifikimit, të pranimit, të aprovimit dhe të hyrjes në fuqi, çdo palë mund të deklarojë se, lidhur me të, çdo amendament i shtojcave A, B ose C do të hyjë në fuqi vetëm me depozitim të instrumentit të tij të ratifikimit, të pranimit, të aprovimit dhe të hyrjes në të.

V. Hyrja në fuqi

1. Kjo Konventë do të hyjë në fuqi ditën e 19-të pas datës së depozitimit të instrumentit të pestë të ratifikimit, të pranimit, të aprovimit dhe të hyrjes në të.

2. Për çdo shtet dhe organizatë rajonale të integritit ekonomik që ratifikon, pranon ose aprovon këtë Konventë ose hyn në të pas depozitimit të instrumentit të pestë të ratifikimit, pranimit, aprovimit dhe hyrjes në të, Konventa do të hyjë në fuqi ditën e 19-të pas datës së depozitimit nga shteti ose organizata rajonale e integritit ekonomik të instrumentit të ratifikimit, të pranimit, të aprovimit dhe të hyrjes në të.

3. Për qëllimet e paragrafëve 1 dhe 2, çdo instrument i depozituar nga një organizatë rajonale e integritit ekonomik nuk do të llogaritet si shtesë e atyre të depozituara nga shtetet anëtare të asaj organizate.

W. Rezervat

Asnjë rezervë nuk mund të bëhet për këtë Konventë.

X. Tërheqja

1. Në çdo kohë pas tre vjetësh nga data në të cilën Konventa hyn në fuqi për një palë, ajo palë mund të tërhiqet nga Konventa duke bërë njoftimin me shkrim në vendin e depozitimit.

2. Çdo tërheqje e tillë do të veprojë në fund të një viti nga data e marrjes së njoftimit, të terheq nga vendi i depozitimit ose në një datë tjetër të mëvonshme siç mund të specifikohet në njoftimin e tërheqjes.

Y. Vendi i depozitimit

Sekretari i Përgjithshëm i Kombeve të Bashkuara do të jetë vendi i depozitimit të kësaj Konvente.

Z. Teksti autentik

Origjinali i kësaj Konvente, tekstet në arabisht, kinezisht, anglisht, frëngjisht, rusisht dhe spanjisht të të cilit janë autentik në mënyrë të barabartë, do të depozitohen te Sekretari i Përgjithshëm i Kombeve të Bashkuara.

Në prani të njëri-tjetrit të nënshkruarit, të autorizuar plotësisht për këtë, kanë nënshkruar këtë Konventë.

Stokholm, më 22 maj 2001.

Shtojca A: Eliminimi

PJESA I

Kimikati	Aktiviteti	Përrjashtim i veçantë
Aldrin* CAS No: 309-00-2	Prodhimi Përdorimi	Asnjë Ektoparazicide lokale Insekticide
Clordane* CAS no: 57-74-9	Prodhimi Përdorimi	Siç lejohet për palët e radhitura në regjistër Ektoparasiticide lokale Insekticide Termiticid Termiticid në ndërtesa dhe diga Termiticide në rrugë Shtesë në ngjitësit e kompetatave
Dieldrin* CAS no: 60-57-1	Prodhimi Përdorimi	Asnjë Në operacionet bujqësore
Endrin*	Prodhimi	Asnjë
CAS No: 72-20-8	Përdorimi	Asnjë
Heptachlor*	Prodhimi	Asnjë
CAS No: 76-44-8	Përdorimi	Termiticid Termiticid në strukturat e shtëpive

		Termiticid (nëntokësor) Trajtimin e drurit Në përdorim në kutitë e kabllove nëntokësorë
Hexachlorobenzene CAS No:118-74-1	Prodhimi Përdorimi	Siç lejohet për Palët e radhitura në regjistër Komponim i ndërmjetëm tretës në pesticide komponim i ndërmjetëm i kufizuar në vende me sistem të mbyllur
Mirex* CAS No: 2385-85-5	Prodhimi Prodhimi	Siç lejohet për Palët e radhitura në regjistër Termiticid
Toxaphene* CAS No: 8001-35-2	Përdorimi Prodhimi	Asnjë Asnjë
Polychlorinated Biphenyls (PCB)*	Përdorimi	Artikujt në përdorim me kushtet e pjesës II të kësaj shtojce

Shënim.

i) Me përjashtim kur specifikohet ndryshe në Konventë, sasitë e kimikateve që ndodhen si infektues të paktë të paqëllimtë në produktet dhe artikujt nuk do të konsiderohen për t'u futur në listën në këtë shtojcë.

ii) Ky shënim nuk do të konsiderohet si përjashtim i veçantë i një prodhimi dhe përdorim për qëllime të nenit D.1 bis. Sasitë e kimikateve që ndodhen si përbërës të artikujve të prodhuar ose tashmë në përdorim, para ose në datën e hyrjes në fuqi të detyrimeve përkatëse lidhur me atë kimikat, nuk do të konsiderohet e futur në listën në këtë shtojcë, me kusht që një palë ka njoftuar sekretariatit se një lloj i veçantë artikulli mbetet në përdorim brenda asaj pale. Sekretariati do t'i bëjë publike njoftime të tilla.

iii) Ky shënim, i cili nuk zbatohet për një kimikat që ka një yll pas emrit të tij në kolonën kimikati në pjesën I të kësaj shtojce, nuk do të konsiderohet si përjashtim i veçantë i një prodhimi dhe përdorimi për qëllime të paragrafit 1 bis të nenit D. Duke marrë parasysh që asnjë sasi kimikati nuk pritet që të arrijë te njerëzit dhe mjedisi gjatë prodhimit dhe përdorimit i një komponimi ndërmjetës të kufizuar në vend me sistem të mbyllur, një palë, pas njoftimit të Sekretariatit, mund të lejojë prodhimin dhe përdorimin e sasive të një kimikati të listës në këtë shtojcë si një ndërmjetës në vend të kufizuar dhe sistem të mbyllur që transformohet kimikisht në manifaturimin e kimikateve të tjerë që, duke marrë parasysh kriteret në paragrafin 1 të shtojcës D, nuk do të shfaqin karakteristikat e ndotësve organikë të qëndrueshëm. Ky njoftim do të përfshijë informacionin mbi prodhimin dhe përdorimin e kimikatit të tillë ose një vlerësim të arsyeshëm të infomacionit të tillë dhe informacionit që ka të bëjë me natyrën e procesit të kufizuar të vendit të sistemit të mbyllur, duke përfshirë sasinë e çdo infektuesi të paktë të paqëllimtë dhe të patransformuar të materialit fillestar-ndotës organik i qëndrueshëm në produktin final. Kjo procedurë zbatohet në të gjitha rastet, me përjashtim nëse ndryshe në këtë shtojcë. Sekretariati do t'i verë këto njoftime në dispozicion të konferencës së palëve dhe të publikut. Prodhimi ose përdorimi i tillë nuk do të konsiderohet përjashtim i veçantë i prodhimit dhe e përdorimit. Prodhimi dhe përdorimi i tillë do të ndërpritet pas një periudhë 10-vjeçare, në qoftë se palët e interesuara nuk dorëzojnë një njoftim të ri të sekretariatit. Në këtë rast, periudha do të shtrihet për një 10-vjeçar tjetër në qoftë se konferenca e palëve, pas një shqyrtimi të prodhimit dhe të përdorimit nuk do të vendosë ndryshe. Procedura e njoftimit mund të përsëritet.

iv) Të gjitha përjashtimet në këtë shtojcë mund të ushtrohen nga palët që kanë regjistruar përjashtimet lidhur me to në përputhje me nenin R bis, me përjashtim të përdorimit të bifenilnit të poliklorinuar në artikujt në përdorim, në përputhje me kushtet e pjesës II të kësaj shtojce e cila mund të ushtrohet nga të gjitha palët.

PJESA II
BIFENIL TË POLIKLORINUAR

Shtetet palë

a) Lidhur me eliminimin e përdorimit të bifenilsit të poliklorinuar në pajisje (p.sh. transformatorë, kondensatorë ose kontejnerë të tjerë që përmbajnë rezerva lëngjesh) nga viti 2025, duke iu nënshtruar shqyrtimit nga konferenca e palëve, të merren veprime në përputhje me përparësitë e mëposhtme:

i) Të bëjnë përpjekje të vendosura për të identifikuar, etiketuar dhe hequr nga përdorimi pajisjet që përmbajnë më shumë se 10% bifenils të poliklorinuar dhe vëllime më të mëdha se 5 litra;

ii) Të bëjnë përpjekje të vendosura për të identifikuar, etiketuar dhe hequr nga përdorimi pajisjet që përmbajnë më shumë se 0.05 % bifenils të poliklorinuar dhe vëllime më të mëdha se 5 litra;

iii) Të bëjnë përpjekje të vendosura për të identifikuar, etiketuar dhe hequr nga përdorimi pajisjet që përmbajnë më shumë se 0.005 % bifenils të poliklorinuar dhe vëllime më të mëdha se 0.05 litra:

b) Në përputhje me përparësitë në nënparagrafin (a) të nxitin masat e mëposhtme për të reduktuar ekspozimet dhe rrezikun, për të kontrolluar përdorimin e bifenilsin e poliklorinuar:

(i) Të përdorin vetëm pajisje të pandashme dhe që nuk rrjedhin (pikojnë) dhe vetëm në zona ku risku nga shkarkimi në mjedis rrethor të minimizohet dhe të rregullohet shpejt;

ii) Të mos përdorin në pajisje në zona pranë prodhimit ose përpunimit të ushqimeve për njerëz dhe kafshë:

iii) Kur përdorin në zona të populluara, duke përfshirë shkollat dhe spitalet, të gjitha masat e arsyeshme për t'u mbrojtur nga defektet elektrike që rrethor të çojnë në zjarr dhe inspektimi i rregullt i pajisjeve për rrjedhje.

c) Pavarësisht nga paragrafi 1 bis i nenit D, të sigurojnë që pajisjet që përmbajnë bifenils të poliklorinuar, siç përshkruhet në nënparagrafin (a) nuk do të eksportohen ose importohen për qëllime të administrimit ambientalisht të pastër të mbeturinave.

d) Me përjashtim të operacioneve të mirëmbajtjes dhe shërbimit, të mos lejojnë rikuperimin për qëllime ripërdorimi të pajisjeve të tjera të lëngjeve me përmbajtje bifenils të poliklorinuar mbi 0.005 %.

e) Të bëjnë përpjekje të vendosura që shërbejnë për të drejtuar administrimin ambientalisht të pastër të mbeturinave të lëngjeve që përmbajnë bifenils të poliklorinuar dhe pajisjet të infektuara me bifenils të poliklorinuar që kanë përmbajtje prej 0.005 % të bifenilsit të poliklorinuar, në përputhje me paragrafin 4 të nenit D, sa më shpejt që të jetë e mundur, por jo më vonë se 2028, duke iu nënshtruar shqyrtimit nga konferenca e palëve.

f) Në vend të pikës (ii) të pjesës I të kësaj shtojce, të bëjnë përpjekje për të identifikuar artikuj të tjerë që përmbajnë më shumë se 0.005 % bifenils të polikloruar (p.sh. mbështjellëset e kabllave, taposjet dhe objektet e lyera) dhe të administrohen ato në përputhje me paragrafin 4 të nenit D.

g) Të japin një raport çdo pesë vjet mbi progresin në eliminimin e bifenilsit të poliklorinuar dhe të dorëzohet ai në konferencën e palëve në pajtim me nenin L.

h) Raportet e përshkuara në nënparagrafin (g) do të konsiderohen, përkatësisht, nga konferenca e palëve në shqyrtimet e saj lidhur me bifenilsin e poliklorinuar. Konferenca e palëve do të shqyrtojë programin drejt eliminimit, të bifenilsit të poliklorinuar në intervale kohore 5-vjeçare ose periudha të tjera, duke marrë parasysh raporte të tilla.

Shtojca B: Kufizimet

PJESA I		
Kimikati	Aktiviteti	Qëllimi i pranueshëm ose përjashtimi i veçantë
DDT	Prodhimi	Qëllimi i pranueshëm:

(1,1, I-tric loro- 2,2-bis
(4 klorofenil) ethane)
CAS No: 50-29-3

Përdorimi

Përdorimi i kontrollit të vektorit të sëmundjes në përputhje me pjesën II të kësaj shtojce
Përjashtime të veçanta:
Ndërmjetës në prodhimin e përzierjes së dekofolit
Qëllimi i pranueshëm:
Përdorimi i kontrollit të vektorit të sëmundjes në përputhje me pjesën II të kësaj shtojce
Përjashtime të veçanta:
Prodhimi i përzierjes së dekofolit

Shënim.

i) Me përjashtim kur specifikohet ndryshe në Konventë, sasitë e kimikateve që ndodhen si infektues të paktë të paqëllimtë në produktet dhe artikujt nuk do të konsiderohen për t'u futur në listë në këtë shtojcë;

ii) Ky shënim nuk do të konsiderohet si qëllim i pranueshëm ose përjashtim i veçantë i një prodhimi dhe përdorimi për qëllime të paragrafit 1 bis të këtij nenit D. Sasitë e kimikateve që ndodhen si përbërës të artikujve të prodhuar ose tashmë në përdorim para ose në datën e hyrjes në fuqi të detyrimeve përkatëse lidhur me atë kimikat, nuk do të konsiderohen për t'u futur në listë në këtë shtojcë, me kusht që një palë ka njoftuar sekretariatit se një lloj i veçantë artikulli mbetet në përdorim brenda asaj pale. Sekretariati do t'i bëjë publike njoftime të tilla;

iii) Ky shënim nuk do të konsiderohet si përjashtim i veçantë i një prodhimi dhe përdorimi për qëllime të paragrafit 1 bis të nenit D. Duke marrë parasysh që asnjë sasi kimikati nuk pritet që të arrijë tek njerëzit dhe mjedisi gjatë prodhimit dhe përdorimi i një ndërmjetësi në vend të kufizuar dhe sistemi të mbyllur, një palë, pas njoftimit të sekretariatit, mund të lejojë prodhimin e përdorimin e sasive të një kimikati të listës në këtë shtojcë si një ndërmjetës në vend të kufizuar dhe sistem të mbyllur që transformohet kimikisht në prodhimin e kimikateve të tjera që, duke marrë parasysh kriteret në paragrafin 1 të shtojcës D, nuk do të shfaqin karakteristikat e ndotësve organikë të qëndrueshëm. Ky njoftim do të përfshijë informacionin mbi prodhimin dhe përdorimin e kimikatit të tillë ose një vlerësim të arsyeshëm të informacionit të tillë dhe informacionit që ka të bëjë me natyrën e procesit të kufizuar të vendit të sistemit të mbyllur, duke përfshirë sasinë e çdo infektuesi të paktë të paqëllimtë dhe të patransformuar të materialit fillestar, ndotës organik i qëndrueshëm në produktin final. Kjo procedurë zbatohet në të gjitha rastet me përjashtim, nëse specifikohet ndryshe në këtë shtojcë. Sekretariati do t'i vërë këto njoftime në dispozicion të konferencës së palëve dhe të publikut. Prodhimi ose përdorimi i tillë nuk do të konsiderohet përjashtim i veçantë i prodhimit dhe përdorimit. Prodhimi dhe përdorimi i tillë do të ndërpritet pas një periudhe 10-vjeçare, në qoftë se Palët e interesuara nuk dorëzojnë një njoftim të ri të sekretariatit. Në këtë rast, periudha do të shtrihet për një 10- vjeçar tjetër në qoftë se konferenca e palëve, pas një shqyrtimi të prodhimit dhe të përdorimit nuk do të vendosë ndryshe. Procedura e njoftimit mund të përsëritet;

iv) Të gjitha përjashtimet në këtë shtojcë mund të ushtrohen nga palët që kanë regjistruar përjashtimet lidhur me to në përputhje me nenin R bis.

PJESA II

DDT (1,1,1-TRICLORO -2,2-BIS (4 KLOOROFENIL) ETHANE)

1. Prodhimi dhe përdorimi i DDT do të eliminohet me përjashtim të palëve që kanë njoftuar sekretariatit për synimin e tyre për ta prodhuar dhe/ose përdorur atë. Veç kësaj krijohet një regjistër i DDT-së dhe do të jetë në dispozicion të publikut.

2. Çdo palë që prodhon dhe/ose përdor DDT do të kufizojë prodhimin dhe/ose përdorimin për kontrollin e vektorit të sëmundjes në përputhje me rekomandimet e Organizatës Botërore të Shëndetësisë dhe udhëzimet mbi përdorimin e DDT-së për kontrollin e vektorit të sëmundjes dhe kur alternivat e parrezikshme, efektive dhe të përballueshme lokalisht nuk janë në dispozicion të palës në

fjalë.

3. Në rastin kur një palë që nuk është në listën e regjistrit të DDT vendos se ajo kërkon DDT për kontrollin e vektorit të sëmundjes, ajo do të njoftojë sekretariatit sa më shpejt të jetë e mundur me qëllim që të shtohet emri në regjistrin e DDT-së. Në të njëjtën kohë ajo do të njoftojë Organizatën Botërore të Shëndetësisë.

4. Çdo tre vjet, çdo palë që përdor DDT do t'i japë sekretariatit dhe Organizatës Botërore të Shëndetit informacionin mbi sasinë e përdorur, kushtet e përdorimit dhe lidhjen e saj me atë strategji të palës për menaxhimin e sëmundjes, në një format që do të vendoset nga konferenca e palëve në konsultim me Organizatën Botërore të Shëndetësisë.

5. Me synim reduktimin dhe përfundimisht eliminimin e përdorimit të DDT-së, konferenca e palëve do të inkurajojë:

a) çdo palë që përdor DDT të zhvillojë dhe të zbatojë një plan veprimi si pjesë e planit të zbatimit të specifikuar në nenin E. Ai plan duhet të përfshijë:

i) zhvillimin e mekanizmave rregullues dhe mekanizmave të tjerë për të siguruar që përdorimi i DDT-së të kufizohet në kontrollin e vektorit të sëmundjeve;

ii) zbatimin e produkteve, metodave dhe strategjive alternative të përshtatshëm, duke përfshirë strategjitë e administrimit të rezistencës për të siguruar efektivitetin e vazhdueshëm të këtyre alternativave;

iii) masat për të forcuar kujdesin për shëndetin dhe për të reduktuar prekshmërinë nga sëmundjet.

b) Palët, brenda kapaciteteve të tyre, të nxisin kërkimet dhe zhvillimin e produkteve kimike dhe jokimike alternative të parrezikshme, metoda dhe strategji të palëve që përdorin DDT, lidhur me kushtet e atyre vendeve dhe me synimin për të ulur barrën humane dhe ekonomike të sëmundjes. Faktorët që duhen nxitur kur konsiderohen alternativat ose kombinimet e tyre do të përfshijnë rreziqet e shëndetit të njerëzve dhe implikimet mjedisore të alternativave të tilla. Alternativat e qëndrueshme ndaj DDT-se do të paraqesin rrezik për shëndetin e njerëzve dhe mjedisin, do të jenë të përshtatshme për kontrollin e sëmundjes, bazuar në kushtet e Palëve në fjalë dhe do të mbështeten me të dhëna monitoruese.

6. Duke filluar në mbledhjen e saj të parë dhe të paktën çdo tre vjet pas kësaj, konferenca e palëve, në konsultim me Organizatën Botërore të Shëndetësisë, do të vlerësojë nevojën e vazhduar për DOT për kontrollin e vektorit të sëmundjeve mbi bazën e informacionit shkencor, teknik, mjedisor dhe ekonomik në dispozicion, duke përfshirë:

a) prodhimin dhe përdorimin e DDT-së dhe kushtet e përcaktuara në paragrafin 2;

b) vënia në dispozicion, përshtatja dhe zbatimi i alternativave të DDT-së; dhe

c) progresin në forcimin e kapaciteteve të vendeve për të transferuar në mënyrë të sigurtë mbështetjen në këto alternativa.

7. Një palë mund në çdo kohë të tërheqë emrin e saj nga regjistri i DDT-së pas njoftimit me shkrim të sekretariatit. Tërheqja do të hyjë në fuqi në datën e specifikuar në njoftim.

SHTOJCA C

Pjesa I: Ndotësit organikë të qëndrueshëm sipas kërkesave të paragrafit 3 të nenit D

Kjo shtojcë përdoret për ndotësit organikë të qëndrueshëm kur formohen dhe çlirohen në mënyrë të paqëllimshme nga burime antropogjene:

Kimikati

Dioksinë-dibenzo-p e poliklorinuar dhe dibenzofurans (PCDD/PCDF)

Heksaklorobenzene (HCB) (CAS No: 118-74-1)

Bifenils i poliklorinuar (BCB)

PJESA III KATEGORITË E BURIMEVE

Dioksinë-dibenzo-p e poliklorinuar dhe dibenzotrans, heksaklorobenzene dhe bifenils i poliklorinuar janë formuar dhe çliruar në mënyrë të paqëllimshme nga procese termike që përfshijnë substancë në mjedis:

- a) Krematorët e mbeturinave, duke përfshirë krematorët e përbashkët të bashkisë, të mbeturinave të rrezikshme ose mjekësore, ose të fundërrinave të ujërave të zeza;
- b) Furrat e çimentos për djegien e mbeturinave të rrezikshme;
- c) Prodhimi i celulozës duke përdorur klor ose kimikatë që çlirojnë klor elementar për zbardhje;
- d) Proceset e mëposhtme termale në industrinë metalurgjike:
 - i) prodhimi dytësor i bakrit;
 - ii) uzinat në industrinë e hekurit dhe të çelikut;
 - iii) prodhimi dytësor i aluminit;
 - iv) prodhimi dytësor i zinkut.

PJESA II KATEGORITË E BURIMEVE

Dioksinë-dibenzo-p e poliklorinuar dhe dibenzofurans, heksaklorobenzene dhe bifenils i poliklorinuar mund të formohen dhe çlirohen gjithashtu në mënyrë të paqëllimshme nga kategoritë e burimeve të mëposhtme, duke përfshirë:

- a) djegien e hapur të mbeturinave, duke përfshirë djegien e vendeve me dhe të hedhur;
- b) proceset termale në industrinë metalurgjike që nuk është përmendur në pjesën II;
- c) burimet e djegies rezidenciale;
- d) shërbimet komunale të djegies me karburantë të fosileve dhe kaldajat e industrisë;
- e) proceset specifike të prodhimit të kimikateve që çlirojnë noq të formuar në mënyrë të paqëllimshme, veçanërisht prodhimi i klorofenikolit dhe kloranilit;
- f) krematorët;
- g) automjetet me motor, veçanërisht ata që djegin benzinë me plumb;
- h) shkatërrimin e skeleteve të kafshëve;
- i) ngjyrosjen (me kloranil) dhe përpunimin (me nxjerrje alkaline) të tekstileve dhe lëkurëve;
- j) uzinat Shredder për trajtimin e makinave në fund të jetës së tyre;
- k) djegien pa flakë e kablllove të bakrit;
- l) uzinat e rafinerimit të vajit të përdorur.

PJESA IV PËRKUFIZIMET

1. Për qëllime të kësaj shtojcë:

a) “Bifenils i poliklorinuar” nënkupton komponime aromatike të formuara në mënyrë të tillë që atomet e hidrogjenit mbi molekulën bifenil (dy unaza benzene të lidhura nga një lidhje e vetme karbo-karbon) mund të zëvendësohen nga deri 10 atome klor; dhe

b) “Dioksinë Dibenze-p i poliklorinuar” dhe dibenzofurans i poliklorinuar janë komponime aromatike triciklike të formuara nga dy unaza benzene të lidhura me dy atome oksigjen në dioksinë dibenzp—p dhe me një atom oksigjen dhe një lidhje karbon-karbon në dibenzofurans të poliklorinuar dhe atomet e hidrogjenit prej të cilëve mund të zëvendësohen deri në 8 atome klori.

c) Në këtë shtojcë, toksiteti i dioksinës dibenze-p e poliklorinuar dhe dibenzofurans i poliklorinuar shprehet duke përdorur konceptin e ekuivalences toksike e cila mat aktivitetin relativ toksik tip-dioksine të përbërësve të ngjashëm të dioksinës dibenzë-p i poliklorinuar dhe dibenzofurans i poliklorinuar dhe bifenilsin e poliklorinuar bashkëplanor në krahasim me dioksinen-p-tetrakloridibenzo-2,3,7,8. Vlerat e faktorit toksik ekuivalent që do të përdoren për qëllime të kësaj Konvente do të jenë në përputhje me standardet e pranuara ndërkombëtare, duke filluar me vlerat e faktorit toksik ekuivalent të Organizatës Botërore të Shëndetësisë për dioksinën dibenze-p të poliklorinuar dhe dibenzofurans i poliklorinuar dhe bifenilsin e poliklorinuar bashkëplanor. Koncentratet shprehen në ekuivalentë toksik.

PJESA V UDHËZIME TË PËRGJITHSHME MBI TEKNIKAT MË TË MIRA NË DISPOZICION DHE

PRAKTIKAT MJEDISORE MË TË MIRA

Kjo pjese u jep palëve udhëzime të përgjithshme mbi parandalimin dhe reduktimin e shkarkimit të kimikateve të listës në pjesën I.

A. Masat e përgjithshme parandaluese lidhur me teknikat më të mira në dispozicion dhe praktikat mjedisore më të mira.

Përparësi duhet t'i jepet gjykimit të metodave për të parandaluar formimin dhe shkarkimin e kimikateve të listës në pjesën I. Masat e domosdoshme mund të përfshinin:

- a) përdorimin e teknologjisë me prodhim të ulët mbeturinash;
- b) përdorimin e substancave më pak të rrezikshme;
- c) nxitjen e rikuperimit dhe riciklimit të mbeturinave dhe të substancave që gjenerohen dhe përdoren në një proces;
- d) zëvendësimi i materialeve ushqyese që janë ndotës organik të qëndrueshëm ose ku ka lidhje të drejtpërdrejtë ndërmjet materialeve dhe shkarkimit të ndotësve organikë të qëndrueshëm nga burimi;
- e) programet për mbajtjen mirë të shtëpive dhe mirëmbajtjen parandaluese;
- f) përmirësimet në administrimin e mbeturinave me qëllim që t'i jepet fund djegies në terren të hapur dhe djegieve të tjera të pakontrolluara të mbeturinave, duke përfshirë djegien e vendeve me dhe të hedhur. Kur shqyrtohen propozimet për ndërtimin e fasiliteve të reja për shkatërrimin e mbeturinave, prioritet duhet t'u jepet alternativave të tilla si aktivitetet për të minimizuar gjenerimin e mbeturinave bashkiake dhe mjekësore, duke përfshirë rikuperimin e burimeve, ripërdorimin, riciklimin, ndarjen e mbeturinave dhe nxitjen e produkteve që gjenerojnë më pak mbeturina. Sipas kësaj metode, duhet të shihen me shumë kujdes problemet e shëndetit publik;
- g) minimizimi i këtyre kimikateve si infektues të produkteve;
- h) shmangia e klorit elemental ose kimikateve që gjenerojnë klor elemental për zbardhje.

B. Teknikat më të mira në dispozicion

Koncepti i teknikave më të mira në dispozicion nuk ka si qëllim rekomandimin për ndonjë teknikë a teknologji të veçantë, por marrjen parasysh të karakteristikave teknike të instalimit që ka lidhje me të, pozicionin gjeografik dhe kushtet e mjedisit lokal. Teknikat e përshtatshme të kontrollit për të reduktuar shkarkimet e kimikateve të listës në pjesën I janë përgjithësisht të njëjta. Në përcaktimin e teknikave më të mira në dispozicion, konsideratë e veçantë duhet t'i jepet, përgjithësisht ose në raste të veçanta, faktorëve të mëposhtëm, duke pasur parasysh kostot dhe përfitimet e mundshme të një mase dhe konsideratë për parandalimin:

- a) Konsiderata të përgjithshme:
 - i) Natyra, efektet dhe masa e shkarkimit përkatës: teknikat mund të ndryshojnë në varësi të madhësisë së burimit;
 - ii) data e blerjes për instalimet ekzistuese ose të reja;
 - iii) koha që nevojitet për të futur teknikën më të mirë në dispozicion;
 - iv) konsumimi dhe natyra e lëndëve të para që përdoren në procesin dhe efikasitetin e energjisë së tyre;
 - v) nevoja për të parandaluar ose reduktuar në minimum ndikimin e përgjithshëm të shkarkimeve në mjedis dhe rreziqet ndaj tij;
 - vi) nevoja për të parandaluar aksidentet dhe për të minimizuar pasojat e tyre për mjedisin;
 - vii) nevoja për të siguruar shëndetin dhe masat e sigurimit në punë;
 - viii) proceset, fasilitetet dhe metodat e veprimit që janë provuar me sukses në shkallë industrië;
 - ix) Përparimet dhe ndryshimet teknologjike në njohuritë dhe kuptimin shkencor.
- b) Masat e përgjithshme për reduktimin e shkarkimit: Në përcaktimin e propozimeve për të ndërtuar fasilite të reja ose për të modifikuar fasilitetet ekzistuese që përdorin proceset që çlirojnë kimikate të listës në këtë shtojcë, konsideratë prioritare proceseve, teknikave dhe praktikave alternative që kanë dobishmëri të njëjtë, pra që shmangin formimin dhe shkarkimin e kimikateve të tilla. Në rastet kur fasilite të tilla do të ndërtohen ose do të modifikohen rrënjësisht, përveç masave parandaluese të skicuara në seksionin A të pjesës V, mund të konsiderohen gjithashtu masa të mëposhtme të reduktimit në përcaktimin e teknikave më të mira në dispozicion:

i) Përdorimi i metodave për pastrimin me gaz të oxhakëve si p.sh. oksidimi termal ose katalitik, preceptimet e pluhurit ose absorbimi;

ii) Trajtimi i mbetjeve, ujërave të përdorur, mbeturinave dhe fundërrinave të ujërave të zeza p.sh., me aile të trajtimit termik a duke i kthyer ato në inerte ose procese kimike që e eliminojnë veprimin helmues të tyre;

iii) Ndryshimet e proceseve që çojnë në reduktimin ose eliminimin e shkarkimeve p.sh., ndërsa levizin për të sistemet e mbyllura;

iv) Modifikimi i procesit shërben për të përmirësuar djegien dhe për të parandaluar formimin e kimikateve të listës në këtë shtojcë, nëpërmjet kontrollit të parametrave të tillë si temperatura e djegies ose koha e qëndrimit.

C. Praktikat mjedisore më të mira

Konferenca e palëve mund të hartojë një udhëzues në lidhje me praktikat mjedisore më të mira.

SHTOJCA D KËRKESAT PËR INFORMACION DHE KRITERET E SCREENING

1. Palët që dorëzojnë një propozim për t'u futur në listë një kimikat në shtojcat A, B dhe/ose C do të identifikojë kimikatin në mënyrën e përshkruar në nënparagrafin (a) dhe do të sigurojë informacionin mbi kimikatin, si dhe produktet e tij të transformimit, lidhur me kriteret e screening të përcaktuara në nënparagrafët (b) deri (e):

a) Identiteti i kimikatit:

i) emrat, duke përfshirë emrin ose emrat e markës, të tregtimit dhe sinonimet, numrin e regjistrit të shërbimit të abstrakteve kimike (SHAK), emrin e Unionit Ndërkombëtar të Pastërtisë dhe të Kimisë së Aplikuar;

ii) Struktura, duke përfshirë specifikimin e isomereve, kur është praktike, dhe struktura e kategorisë kimike.

b) Qëndrueshmëria:

i) Dëshmia se periudha e gjysmëshpërbërjes së kimikatit në ujë është më e madhe se dy muaj, ose se periudha e gjysmëshpërbërjes në tokë është më e madhe se gjashtë muaj, ose se periudha e gjysmëshpërbërjes në sediment është më e madhe se gjashtë muaj; ose

ii) Dëshmia se kimikati është mjaft i qëndrueshëm për të justifikuar konsiderimin e brenda sferës së kësaj Konvente.

c) Akumulimi biologjik:

i) Dëshmi që faktori i biopërqendrimit ose faktori i bioakumulimit në speciet ujore për kimikatin është më i madh se 5 000 ose në mungesë të një të dhëne të tillë, që log Ko/w është më i madh se 5;

ii) Dëshmi që një kimikat paraqet arsye të tjera përkuqdesje, si p.sh. akumulimi biologjik i lartë në specie të tjera, toksicitet të lartë ose ekotoksicitet;

iii) Të dhëna monitorimi në bio që tregojnë se potenciali i bioakumulimit të kimikatit është i mjaftueshëm për të justifikuar konsiderimin e tij brenda sferës së kësaj Konvente;

j) Potenciali për transportim në distanca të largëta në mjedis:

i) Nivelet e matura të kimikatit në vendndodhjet larg nga burimi i shkarkimit të tij që janë me interes potencial;

ii) Monitorimi i të dhënave që tregon se transportimi në distanca të largëta në mjedis i kimikatit, me potencial për transferim tek një mjedis marrës, mund të bëhet nëpërmjet ajrit, ujit ose specieve shtegtare;

iii) Vetitë e shkatërrimit të mjedisit dhe/ose rezultatet e modelit demonstrojnë se kimikati ka potencial për transportim në distanca të largëta të mjedisit përmes ajrit, ujit ose specieve shtegtare, me potencial për transferim tek një mjedis marrës në vende larg nga burimi i shkarkimit të tij. Për kimikatin që shtegton kryesisht përmes ajrit, periudha e gjysmëshpërbërjes së tij në ajër është më e madhe se dy ditë.

k) Efektet e kundërta:

i) Dëshmi e efekteve të kundërta tek shëndeti i njerëzve ose në mjedis që justifikon

konsiderimin e kimikatit brenda sferës së kësaj Konvente; ose

ii) Të dhëna të toksicitetit dhe të ekotoksicitetit që tregojnë potencialin për dëmtime ndaj shëndetit të njerëzve ose ndaj mjedisit.

1. Pala propozuese do të japë një deklaratë të arsyeve për përkujdesje duke përfshirë, ku është e mundur, një krahasim të të dhënave të toksicitetit ose ekotoksicitetit me nivelet e diktuara ose të parashikuara të një kimikati që rezulton ose parashikohet nga transportimi në distancë të largët në mjedis dhe një deklaratë të shkurtër që tregon nevojën për kontroll global.

2. Pala propozuese, deri sa është e mundur dhe duke marrë parasysh kapacitetet e saj, do të sigurojë informacione të tjera shtesë për të mbështetur shqyrtimin e propozimit të referuar në paragrafin 4 të nenit F. Në zhvillimin e një propozimi të tillë, një palë mund të shfrytëzojë ekspertizën teknike nga çdo burim.

SHTOJCA E KËRKESA PËR INFORMACION PËR PROFILIN E RREZIKUT

Qëllimi i shqyrtimit është të vlerësojë nëse kimikati ka mundësi, si rezultat i transportimit në distancë të largët në mjedis, të çojë në efekte të kundërta të rëndësishme për shëndetin e njerëzve dhe/ose mjedisit, saqë të justifikojë veprimin global. Për këtë qëllim, një profil rreziku do të zhvillohet që përpunon më tej dhe vlerëson informacionin e referuar në shtojcën D dhe përfshin, sa të jetë e mundur, tipet e mëposhtme të informacionit:

a) burimet, duke përfshirë përkatësisht:

i) të dhënat e prodhimit, duke përfshirë sasinë dhe vendndodhjen;

ii) përdorimet dhe

iii) shkarkimet, si shkarkimet, humbjet dhe përhapjet.

b) vlerësimin e rrezikut për pikën ose pikat e fundit të shqetësimit, duke përfshirë konsideratën e ndërveprimit toksikologjik që përfshin kimikate të shumëfishta.

c) shkatërrimin e mjedisit, duke përfshirë të dhënat dhe informacionin mbi vetitë kimike dhe fizike të një kimikati, si dhe qëndrueshmërinë e tij dhe se si janë të lidhur ata me transportimin dhe transferimin në mjedis brenda dhe ndërmjet ndarjeve mjedisore, degradimin dhe transformimin e tyre në kimikate të tjera. Përcaktimi i faktorit të biopërqendrimit ose bio akumulimit, bazuar në vlerat e matura, do të jetë në dispozicion, me përjashtim të rasteve kur të dhënat e monitorimit gjykojnë se plotësojnë këtë nevojë.

d) të dhënat e monitorimit;

e) ekspozimin në zonat lokale dhe, në veçanti, si rezultat i transportimit në distanca të largëta mjedisore, duke përfshirë informacionin lidhur me biovlefshmërinë;

f) vlerësimet ose profilet ndërkombëtare të rreziqeve dhe etiketimi i klasifikimeve të informacionit dhe rreziqeve, kur janë të mundshme;

g) statusin e kimikateve sipas konventave ndërkombëtare.

SHTOJCA F INFORMACION MBI KONSIDERATAT SOCIAL-EKONOMIKE

Duhet të ndërmerret një vlerësim lidhur me masat e mundshme të kontrollit për kimikatet sipas konsideratës për përfshirje në këtë Konventë, duke mbuluar të tërë gamën e opsioneve, duke përfshirë administrimin dhe eliminimin. Për këtë qëllim, duhet të sigurohet informacioni përkatës lidhur më konsideratat sociol-ekonomike që shoqërohen me masat e mundshme të kontrollit për të bërë të mundur marrjen e një vendimi nga konferenca e palëve. Një informacion i tillë duhet të reflektojë vlerësimin e duhur për kapacitetet dhe kushtet e ndryshme ndërmjet palëve dhe duhet të përfshijë konsideratën e listës së mëposhtme treguese të artikujve:

a) Efikasiteti dhe efektshmëria e masave të mundshme të kontrollit në plotësimin e synimeve për reduktimin e rreziqeve:

i) fizibiliteti teknik dhe

ii) kostot, duke përfshirë kostot e shëndetit dhe të mjedisit.

b) alternativat (produktet dhe proceset):

i) fizibiliteti teknik;

- ii) kostot, duke përfshirë kostot e shëndetit dhe të mjedisit;
 - iii) efikasiteti;
 - iv) rreziku (risku)
 - v) vlefshmëria;
 - vi) mundësia për hyrje.
- c) Ndikimet pozitive dhe/ose negative mbi shoqërinë e zbatimit të masave të mundshme të kontrollit:
- i) shëndeti, duke përfshirë shëndetin e mjedisit dhe të punës;
 - ii) bujqësia, duke përfshirë kulturat ujore dhe pyjet;
 - iii) biodiversiteti;
 - iv) aspektet ekonomike;
 - v) lëvizja drejt zhvillimit të qëndrueshëm; dhe
 - vi) kostot sociale.
- d) implikimet për mbeturinat dhe asgjësimin e tyre (në veçanti, stoqet e vjetra të pesticideve dhe pastrimi i vendeve të infektuara):
- i) Fizibiliteti teknik;
 - ii) Kostot.
- e) Hyrja në informacion dhe edukimi i publikut.
- e) Statusi i kontrollit dhe kapaciteti i monitorimit.
- f) Çdo veprim kontrolli rajonal ose kombëtar i ndërmarrë, duke përfshirë informacionin mbi alternativat dhe informacione të tjera përkatëse për administrimin e riskut.

SHTOJCA II

REZOLUTAT E MIRATUARA NGA KOMITETI NË SESIONIN E PESTË TË SAJ PËR SHQYRTIM NGA KONFERENCA TË AGJENTËVE DIPLOMATIKË ME AUTORITET TË PLOTË

- A. Rezoluta mbi marrëveshjet financiare të përkohshme
- Konferenca e agjentëve diplomatikë me autoritet të plotë,
duke vënë re se neni K bis mbi marrëveshje financiare të përkohshme Fasilitetin e mjedisit Global mbi bazë të përkohshme të shërbejë si entiteti kryesor i besuar për operacionet e mekanizmit financiar të përcaktuar në nenin K të Konventës së Stokholmit mbi ndotësit organikë të qëndrueshëm,
duke i kushtuar vëmendje dëshirës së fasilitetit të mjedisit global për t'u angazhuar me objektivat e Konventës siç është shprehur në mbledhjen e 16 të Këshillit të saj:
1. I kërkon Asamblesë së Fasilitetit të Mjedisit Global të marrë në konsideratë krijimin e një zone të re qendrore përmes amendamentit të instrumentit për krijimin e fasilitetit të Strukturuar të mjedisit global për të mbështetur zbatimin e Konventës;
 2. I kërkon më tej Këshillit të Fasilitetit të Mjedisit Global të krijojë sa më shpejt të jetë e mundur dhe të zbatojë një program veprimi për ndotësit organikë të qëndrueshëm, duke marrë parasysh vendimet e ardhshme të Komitetit të Negocimit Ndërqeveritar për një instrument detyrues ligjor ndërkombëtar për zbatimin e veprimit ndërkombëtar mbi disa ndotës organikë të qëndrueshëm.
 3. I kërkon më tej Fasilitetit të Mjedisit Global të raportojë në konferencën e palëve në sesionin e saj të parë mbi masat që ai ka ndërmarrë për të siguruar transparencën e procesit të miratimit të projektit të Fasilitetit të Mjedisit Global dhe që procedurat për marrjen e fondeve janë të thjeshta, fleksible dhe të menjëhershme.
 4. U kërkon donatorëve të fondit të besimit të Fasilitetit të Mjedisit Global të kontribuojnë me burime financiare plotësuese të mjaftueshme përmes rifurnizimit të tretë të fondit të besimit të Fasilitetit të Mjedisit Global për të bërë të mundur që Fasiliteti i Mjedisit Global të kryejë me efektivitet mandatin e tij përsa i përket kësaj Konvente.
 5. I kërkon Sekretariatit të përkohshëm të ftojë institucionet përkatëse të financimit të japin informacione mbi mënyrat në të cilat ata mbështesin Konventën dhe të dorëzojnë një raport mbi bazën e një informacioni të tillë te konferenca e palëve në sesionin e saj të parë.
 6. I kërkon konferencës së palëve në sesionin e parë të saj të rishikojë vlefshmërinë e

burimeve financiare që u shtohen atyre të siguruara përmes Fasilitetit të Mjedisit Global dhe mënyrat dhe mjetet për mobilizimin dhe kanalizimin e këtyre burimeve në mbështetje të objektivave të Konventës.

B. Rezoluta mbi çështjet që lidhen me Konventën Basel

Konferenca:

1. Përsëndet punën e marrë përsipër nga organet e Konventës Basel mbi kontrollin e lëvizjeve ndërkufitare të mbeturinave të rrezikshme dhe asgjësimin e tyre mbi çështjet që lidhen me administrimin e mbeturinave ndotës organikë të qëndrueshëm, duke përfshirë fillimin e punës për të përgatitur udhëzuesit teknikë për administrimin ambientalisht të pastër të mbeturinave, ndotës organikë të qëndrueshëm.

2. Inkurajon organet e Konventës së Baselit të vazhdojë ta ketë këtë punë përparësi të saj.

3. Fton organet e Konventës së Baselit të bashkëpunojnë ngushtë për artikujt referuar në paragrafin 4 (d) të nenit D dhe në veçanti të përgatisë udhëzuesit teknikë përkatës për administrimin ambientalisht të pastër të mbeturinave, ndotës organikë të qëndrueshëm.

4. I kërkon Komitetit Ndërqeveritar të Negocimit dhe sekretariatit të përkohshëm të bashkëpunojnë me sekretariatit dhe organet e Konventës së Baselit mbi çështjet që lidhen me administrimin e mbeturinave, ndotës organikë të qëndrueshëm;

5. Fton sekretariatit e Konventës së Baselit të raportojë te Komiteti mbi çështje që lidhen me administrimin e mbeturinave, ndotës organikë të qëndrueshëm, duke përfshirë përgatitjen e udhëzuesve për administrimin ambientalisht të pastër të mbeturinave, ndotës organikë të qëndrueshëm.

C. Tekst që duhet futur në draftrezolutë mbi marrëveshjet e përkohshme

4. bis. Vendos që Komiteti do të zhvillojë një udhëzues provizor mbi vlerësimin shkarkimeve aktuale dhe të parashikuara në shtojcën C, duke përfshirë kryerjen dhe mbajtjen e inventareve të burimeve, për të lehtësuar punën e përkohshme sipas paragrafit 3 (a) (i) të nenit D, për t'u marrë në konsideratë nga konferenca e palëve pas hyrjes në fuqi të Konventës.

4. ter. Vendos gjithashtu që Komiteti do të zhvillojë një udhëzues të përkohshëm mbi praktikën mjedisore më të mira lidhur me kushtet e paragrafit 3 të nenit D, për t'u marrë në konsideratë nga konferenca e palëve pas hyrjes në fuqi të Konventës.

SHTOJCA III

REZOLUTAT E MIRATUARA NGA KOMITETI NË SESIONIN E KATËRT TË TIJ PËR SHQYRTIM NGA KONFERENCA E AGJENTËVE DIPLOMATIKË ME AUTORITET TË PLOTË

Rezolutë lidhur me sekretariatit

Konferenca, e mbledhur në Stokholm, më 22 dhe 23 maj 2001,

1. Përsëndet me vlerësim ofertat bujare për të pritur sekretariatit e Konventës së Stokholmit të marra nga Gjermania dhe nga Zvicra dhe fton vendet e sipërpërmendura të japin informacionin e plotë dhe të detajuar mbi propozimet e tyre.

2. Vëren se paragrafi 3 i nenit P të Konventës për Drejtorin Ekzekutiv të Programit të Kombeve të Bashkuara për Mjedisin për të kryer funksionet e sekretariatit të specifikuar në Konventë.

3. I bën thirrje drejtorit ekzekutiv të programit të Kombeve të Bashkuara për mjedisin të marrë në konsideratë ofertat e marra nga Gjermania dhe Zvicra, si dhe ofertat e tjera dhe të bëjë një analizë të atyre ofertave lidhur me vendndodhjen fizike të sekretariatit për t'u shqyrtuar dhe vendosur nga konferenca e palëve në mbledhjen e saj të parë. Përgatitja e një analize të tillë do të kryhet në konsultim me Komitetin Ndërqeveritar të Negocimit.

SHTOJCA IV

REZOLUTAT PËR SHQYRTIM NGA NGA KONFERENCA E AGJENTËVE DIPLOMATIKË ME AUTORITET TË PLOTË TË SHTRUAR PËR DISKUTIM NË SESIONIN E PESTË TË KOMITETIT SE KOMITETI NUK KISHTE KOHË TË MJAFTUESHME PËR T'I SHQYRTUAR

A. Rezoluta mbi marrëveshjet e përkohshme

Konferenca,
pasi ka adoptuar tekstin e Konventës së Stokholmit mbi ndotësit organik të qëndrueshëm (këtej e tutje i referohemi si “Konventa”),

duke marrë parasysh se marrëveshjet e përkohshme kërkohen me qëllim që të zbatohet menjëherë veprimi ndërkombëtar për të mbrojtur shëndetin e njerëzve dhe mjedisin nga ndotës organikë të qëndrueshëm që pret hyrjen në fuqi të Konventës dhe për t’u përgatitur për funksionimin efektiv të saj sapo të hyjë në fuqi,

duke kujtuar vendimet 18/32 të 25 majit 1995, 19/13 C i shkurtit 1997 dhe 20/24 i shkurtit 1999 të Këshillit Drejtues të Programit të Kombeve të Bashkuara për Mjedisin mbi ndotësit organik të qëndrueshëm,

1. U bën thirrje shteteve dhe organizatave rajonale të integritit ekonomik të caktuara për këtë, të konsiderojnë nënshkrimin, ratifikimin, pranimin, aprovimin dhe hyrjen në Konventë sa më shpejt që të jetë e mundur;

2. Fton Drejtorin Ekzekutiv të Programit të Kombeve të Bashkuara për Mjedisin të mbledhë sesione të mëtejshme të Komitetit Ndërqeveritar të Negocimit (prej këtej “Komiteti”) gjatë periudhës ndërmjet datës në të cilën hapet Konventa për firmë dhe datës së hapjes së mbledhjes së parë të konferencës së palëve, si të nevojshme për të mbikëqyruar zbatimin, gjatë periudhës së ndërmjetme, të veprimit ndërkombëtar për të mbrojtur shëndetin e njerëzve dhe të mjedisit nga ndotësit organikë të qëndrueshëm brenda sferës së Konventës dhe për t’u përgatitur dhe për t’i shërbyer konferencës së palëve deri në fund të vitit fiskal kur të zhvillohet mbledhja e parë e konferencës së palëve;

3. Fton Komitetin për të krijuar organin ndihmës të përkohshëm (për të kryer, gjatë periudhës së ndërmjetme, funksionet e ngarkuara) (për të përgatitur për një fillim të shpejtë të organit ndihmës që duhet krijuar sipas nenit O paragrafit (5 bis) të Konventës;

4. Vendos që (për të mundësuar fillimin e shpejtë për organin ndihmës referuar në paragrafin 4 më sipër) Komiteti do të vendosë, ndërmjet datës në të cilën hapet Konventa për firmë dhe datës së hyrjes në fuqi, (mbi përbërjen e përkohshme, rregullat e procedurës dhe udhëzuesit operacionalë) (mbi listën e përkohshme të çdo kimikati tjetër sipas Konventës në përputhje me kushtet e neneve (F) dhe (O) dhe (R) shtojcat D, E, dhe F të Konventës, për të mundësuar atë të zhvillojë paragrafin 3, 4, dhe 5, grupi i projektimit të ligjeve kërkon udhëzimet politike mbi çfarë procedure të përkohshme, në qoftë se ka ndonjë, është përfytyruar. Delegacionet do të duhet të japin konsideratat për detajet e mekanizmave që *round* të përdoren lidhur me funksionimin e procedurës së përkohshme. Çështjet mund të përfshijnë:

- procedurat për funksionimin e organit të ndërmjetëm;
- listën e mundshme të përkohshme të kimikateve shtesë;
- organin përkatës për të administruar çdo proces listimi të përkohshëm;

5. U bën thirrje shteteve dhe organizatave rajonale të integritit ekonomik të dorëzojnë propozimet për listën e kimikateve (në përputhje me kushtet e nenit F paragrafi 1 i Konventës; dhe për organin ndihmës të përkohshëm të fillojë procesin e *screening* dhe t’i përgatisë ata për shqyrtim nga organi ndihmës kur të krijohet;

5 bis. Fton Komitetin të fokusojë përpjekjet e tij gjatë periudhës së ndërmjetme mbi aktivitetet që do të jenë të nevojshme për zbatimin efektiv të Konventës pas hyrjes në fuqi (p.sh. hapa për të bërë të mundur fillimin e shpejtë të rrjeteve të asistencës për kapacitetin, zhvillimin e modaliteteve dhe procedurave që lidhen me mospërputhjen dhe zhvillimin e rregullave dhe procedurave për adoptim nga konferenca e palëve);

6. U bën thirrje shteteve dhe organizatave rajonale të integritit ekonomik të marrin pjesë dhe të zbatojë plotësisht kushtet e Konventës gjatë periudhës së ndërmjetme mbi baza vullnetare;

7. I kërkon Drejtorit Ekzekutiv të Programit të Kombeve të Bashkuara për Mjedisin t’i sigurojë sekretariatit, gjatë periudhës së ndërmjetme, shërbimet për funksionimin e aktiviteteve të ndërmjetme;

8. U bën thirrje shteteve dhe organizatave rajonale të integritit ekonomik të japin kontribute vullnetare tek fondi i besimit të krijuar nga Programi i Kombeve të Bashkuara për Mjedisin për të mbështetur aktivitetet e ndërmjetmer dhe funksionimin e konferencës së palëve deri në fund të vitit fiskal në të cilin bëhet takimi i parë i konferencës së palëve dhe për të siguruar pjesëmarrje të plotë dhe efektive të vendeve në zhvillim dhe vendeve me ekonomi në tranzicion në punën e mëtejshme të Komitetit;

9. U bën thirrje shteteve dhe organizatave rajonale të integritit ekonomik me programe më të përparuara për rregullimin e kimikateve, t'u japë asistencë financiare dhe teknike, duke përfshirë trainimin, shteteve dhe organizatave të tjera rajonale të integritit ekonomik në zhvillimin e infrastrukturës dhe kapacitetit të tyre për të reduktuar, me qëllim eliminimin, ku është e mundur, përdorimet dhe shkarkimet e ndotësve organikë të qëndrueshëm, siç është specifikuar në Konventë, gjatë gjithë ciklit të jetës, veçanërisht duke parë nevojën urgjente që të tilla shtete dhe organizata rajonale të integritit ekonomik kanë për të marrë pjesë në funksionimin efektiv të Konventës, sapo ajo të hyjë në fuqi.³

B. Rezolutë mbi rrjetin e asistencës për kapacitetin

Të bindur që funksionet teknike të rrjetit të asistencës për kapacitetin do të kryheshin më me efikasitet dhe efektivitet nga UNEP-i si sekretariat i parashikuar në paragrafin 3 të nenit P të Konventës dhe se funksionet financiare të saj do të kryheshin më me efikasitet dhe efektivitet nga Fasiliteti i mjedisit Global.

duke dëshiruar që UNEP-i si sekretariat i parashikuar në paragrafin 3 të nenit P të Konventës dhe Fasiliteti i Mjedisit Global do të kryejnë, duke vepruar në bashkëpunim, funksionet e rrjetit të asistencës për kapacitetin,

I bën thirrje kryetarit të Komitetit Ndërqeveritar të Negocimit t'u kërkojë, pa vonesë, organeve drejtuese të programit të Kombeve të Bashkuara për Mjedisin dhe Fasilitetit të Mjedisit Global të shqyrtojnë dhe të vendosin nëse ata do të marrin funksionet e rrjetit të asistencës për Kapacitetin deri në mbledhjen e parë të konferencës së palëve, me qëllim që ata të emërohen në atë mbledhje për të kryer këto funksione mbi baza të vazhdueshme:

- efekti ligjor i paramenduar, në qoftë se ka, i çdo liste të tillë të përkohshme, dhe
- marrëdhëniet ndërmjet çdo liste të përkohshme dhe veprimit pasues nga konferenca e Palëve, lidhur me amendamentin e shtojcave të Konventës.

Grupi i projektimit ligjor do të ketë nevojë ta rishikojë këtë paragraf kur të jetë përfunduar.

I kërkon kryetarit të Komitetit të raportojë mbi këtë çështje në konferencën e agjentëve diplomatikë me autoritet të plotë që do të mbahet në Stokholm nga 22 deri në 23 maj 2001.

C. Rezolutë mbi detyrimet dhe dëmshpërblimet lidhur me përdorimin dhe futjen e qëllimshme në mjedis të ndotësve organikë të qëndrueshëm

Konferenca,

e ndërgjegjshme për rrezikun që paraqesin ndotësit organikë të qëndrueshëm ndaj shëndetit të njeriut dhe mjedisit,

duke pranuar se ndotësit organikë të qëndrueshëm transportohen përmes kufijve ndërkombëtarë dhe depozitohen larg nga vendi i shkarkimit përmes ajrit, ujit dhe specieve shtegtare,

duke ditur se është koha e përshtatshme për diskutime të mëtejshme mbi nevojën për përpunimin e rregullave ndërkombëtare në fushën e detyrimeve dhe dëmshpërblimeve që rezultojnë nga përdorimi i produktit dhe shkarkimi i paramenduar në mjedis i ndotësve organikë të qëndrueshëm,

duke përshëndetur gatishmërinë e Austrisë për të pritur një workshop mbi detyrimet dhe dëmshpërblimet,

1. Fton Qeveritë dhe organizmat ndërkombëtarë përkatës t'i japin informacione sekretariatit mbi masat dhe marrëveshjet kombëtare, rajonale dhe ndërkombëtare mbi detyrimet dhe dëmshpërblimet, veçanërisht mbi ndotësit organikë të qëndrueshëm;

2. I kërkon sekretariatit në bashkëpunim me një ose më shumë shtete, të organizojë një workshop mbi detyrimet dhe dëmshpërblimet, në kontekstin e Konventës mbi ndotësit organikë të qëndrueshëm dhe çështjet që lidhen me ta, jo më vonë se 2002;

3. Vendos të shqyrtojë në konferencën e parë të palëve raportin e *workshopit* me qëllim që të vendoset çfarë veprime të mëtejshme duhen ndërmarrë.

C. Nderime Qeverisë së Mbretërisë së Suedisë

Konferenca,

e mbledhur në Stokholm, më 22 dhe 23 maj 2001 me ftesën bujare të Qeverisë së Mbretërisë së Suedisë,

e bindur se përpjekjet e bëra nga Qeveria e Mbretërisë së Suedisë dhe nga autoritetet e qytetit të Stokholmit në sigurimin e fasiliteve, kushteve dhe resurseve kontribuan ndjeshëm në kryerjen e qetë të punimeve,

me vlerësim të thellë për kortezinë dhe mikëpritjen e treguar nga Qeveria e Mbretërisë së

Suedisë dhe e autoriteteve të qytetit të Stokholmit për anëtarët e delegacioneve, vëzhguesve dhe sekretariatit të Programit të Kombeve të Bashkuara për Mjedisin që ndjekin konferencën, i shpreh mirënjohjen e saj të singertë Qeverisë së Mbretërisë të Suedisë, autoriteteve të qytetit të Stokholmit dhe, përmes tyre, popullit të Suedisë, për mikëpritjen me gjithë zemër që ata i bënë konferencës dhe punimeve të saj dhe për kontributin për zhvillimin me sukses të konferencës.

SHTOJCA V PIKËPAMJET E SHPREHURA NGA ORGANIZATAT JOQEVERITARE

1. Përfaqësuesit e organizatave joqeveritare të njerëzve të varfër, të shëndetit të gruas dhe të mjedisit vërejtën se POPs përbënte kërcënim të madh për shëndetin, veçanërisht për njerëzit e varfër, fëmijët dhe gratë shtatzëna. Ata shkaktojnë deformime tek fetusit dhe kancer si tek të rriturit dhe tek fëmijët. Një përfaqësues theksoi se gratë duhet të marrin pjesë plotësisht në proceset përkatëse vendimmarrëse në çdo nivel. Theks i veçantë u vu mbi rrezikun e dioksideve dhe përfaqësuesit bënë thirrje për eliminimin e tyre. Një përfaqësues i njerëzve të varfër tha se eksperiencia e komuniteteve të varfëra me POPs-in duhet të shërbejë si një paralajmërim i hershëm për njerëzimin, i hershëm për shumicën e anëtarëve të komunitetit ndërkombëtar, por fatkeqësisht, shumë vonë për shumë njerëz të varfër. Disa përfaqësues vunë në dukje rëndësinë e krijimit të një konvente që round të zgjerohet për të mbuluar substancat e reja dhe theksoi nevojën për burime financiare të mjaftueshme në dispozicion të vendeve në zhvillim dhe vendeve me ekonomi në tranzicion për t'iu dhënë mundësi atyre të zbatojnë kushtet e konventës së ardhshme.

2. Përfaqësues të organizatave joqeveritare të shëndetit tërhoqën vëmendjen se malarja përbënte kërcënim të madh për shëndetin në një numër të madh vendesh në zhvillim, veçanërisht në Afrikë: duke pasur kontroll të vazhdueshëm të malarjes bazuar në DDT, në 1996 Afrika llogarit aktualisht 90% të rasteve me malarje në botë. Përkatësisht, ndërsa DDT duhet ndaluar në bujqësi, përdorimi i saj për kontrollin e malarjes duhet të vazhdojë të lejohet, sepse ajo shpëtoi miliona jetë njerëzish.

3. Përfaqësuesi i një organizate të industrisë raportoi për bashkëpunimin ndërmjet organizatës së tij dhe FAO në Afrikë në shkatërrimin e grumbujve të vjetër të pesticideve dhe mbi aktivitetet përkatëse në Amerikën Latine, Azi dhe në Lindjen e Mesme. Përfaqësuesi i një organizate tjetër të industrisë theksoi nevojën që konventa e ardhshme të jetë realiste.

SHTOJCA VI LISTA E KËRKESAVE PËR PËRJASHTIM SHKENCOR NË ANEKSET A DHE B DHE QËLLIMET E PRANUESHME NË SHTOJCËN B TË MARRË PARA MBYLLJES SË SESIONIT TË PESTË TË KOMITETIT

Vendi	Përfashtimi i veçantë ose qëllimi i pranueshëm
Algjeria	Përdorimi i kloradinës si element shtesë në lëndët ngjitëse të kompesatave Përdorimi i kloradinës si termiticid Përdorimi i DDT për kontrollin e vektorit sipas pjesës II të shtojcës Përdorimi i heptaklorit si termiticid Përdorimi i PCBs në pajisjet elektrike
Angola	Përdorimi i PCBs tek transformatorët dhe materialet e tjera që përmbajnë PCB-s akoma në shërbim
Australia	Përdorimi i mirex si termiticid
Bangladesh	Përdorimi i DDT për kontrollin e vektorit
Botsvana	Përdorimi i kloradinës në rrugë
Brazili	Përdorimi i heptaklorit në trajtimin e drurit
Kina	Përdorimi i kloradinës si termiticid Përdorimi i kloradinës si termiticid në ndërtesa dhe diga Prodhimi i hexaklorobenzene si ndërmjetës

	Përdorimi i hexaklorobenzene si ndërmjetës prodhim i mirex si termiticid
	Prodhimi i DDT si ndërmjetës
	Përdorimi i DDT si ndërmjetës
	Prodhimi i DDT për vektorin e sëmundjeve në përputhje me pjesën II të shtojcës B të Konventës së Stokholmit mbi ndotësit organikë të qëndrueshëm.
Komoros	Përdorimi i aldrinës si eltoparasticid dhe inseticid
	Përdorimi i kloradinës si eltoparasticid dhe inseticid
	Përdorimi i DDT për vektorin e sëmundjeve në përputhje me pjesën II të shtojcës B të Konventës së Stokholmit mbi ndotësit organikë të qëndrueshëm
Kosta Rika	Përdorimi i DDT për vektorin e sëmundjeve në përputhje me pjesën II të shtojcës B të Konventës së Stokholmit mbi ndotësit organikë të qëndrueshëm
Kroacia	Përdorimi i PCBs së indentifikueshme në pajisjet që përmbajnë PCBs në vëllime më të mëdha se 5 dm ³ dhe që kanë një përqendrim prej 0.05% PCBs ose më shumë, sa më shpejt të jetë e mundur, dhe jo më vonë se 31 dhjetor 2015.
Ekvadori	Përdorimi i DDT për vektorin e sëmundjeve në përputhje me pjesën II të shtojcës B të Konventës së Stokholmit mbi ndotësit organikë të qëndrueshëm
Etiopia	Përdorimi i DDT për kontrollin e vektorit për shëndetin publik në pajtim me udhëzimet e Organizatës Botërore të Shëndetësisë
India	Përdorimi i DDT për përdorim në kontrollin e vektorit dhe si ndërmjetës në prodhimin e dikofolit
	Përdorimi i DDT për kontrollin e vektorit dhe në prodhimin e dikofolit (të përfshirë në dikofol si infektues (me përqendrim maksimal 0.1%)
	Përdorimi i PCBs në artikujt në përdorim në përputhje me pjesën II të shtojcës A të Konventës së Stokholmit mbi ndotësit organikë të qëndrueshëm.
	Përdorimi i dieldrinës në operacionet bujqësore (2 vjet duhen për të shteruar stoqet e mbetjeve)
Xhamaika	Përdorimi i PCBs në transformatorët që përmbajnë vaj PCB
Japonia	Përdorimi i heptaklorit si termiticid në strukturat e shtëpive
Kenia	Përdorimi i DDT në shëndetin publik për kontrollin e vektorit sipas udhëzimeve të Organizatës Botërore të Shëndetësisë
Lesoto	Përdorimi i PCBs tek transformatorët
Maqedonia (Republikë ish-Jugosllave)	Përdorimi i PCBs së idetifikueshme në pajisjet që përmbajnë PCB-s në vëllime më të mëdha se 5 dm ³ dhe që kanë një përqendrim prej 0.05% PCBs ose më shumë, sa më shpejt të jetë e mundur, dhe jo më vonë se 31 dhjetor 2015.
Madagaskari	Përdorimi i DDT për kontrollin e vektorit sipas pjesës II të shtojcës A dhe B (data e skadimit të afatit/rishikimit 10 vjet)
	Përdorimi i hexaklorobenzene
	Përdorimi i PCBs në pajisjet elektrike
Malavia	Përdorimi i DDT për kontrollin e malarjes
	Përdorimi i PCBs në transformatorët e vjetër që përmbajnë vaj PCB
Mauritania	Përdorimi i DDT për vektorin e sëmundjeve në përputhje me pjesën II të shtojcës B të Konventës së Stokholmit mbi ndotësit organikë të qëndrueshëm.
Maroku	Përdorimi i DDT për kontrollin e vektorit
	Përdorimi i kloradinës si termiticid
	Përdorimi i PCBs në pajisjet elektrike
Mozambiku	Përdorimi i DDT në shëndetin publik për kontrollin e malarjes
	Përdorimi i PCBs në transformatorët
Nigeria	Përdorimi i PCBs në transformatorët që përmbajnë PCB
	Përdorimi i heptaklorit si tretës në pesticide
Panama	Përdorimi i DDT për kontrollin e vektorit për mbrojtjen e shëndetit të njerëzve
Guinea e Re Papua	Përdorimi i heptaklorit si termiticid nëntokësor
	Përdorimi i DDT për kontrollin e vektorit në përputhje me pjesën II të shtojcës B të Konventës së Stokholmit mbi ndotësit organikë të qëndrueshëm
Polonia	Përdorimi i PCBs në pajisjet elektrike

	Përdorimi i hexaklorobenzene në komponimet e ndërmjetme në vende me sistem të mbyllur
Republika e Koresë	Përdorimi i kloradinës si element shtesë në lëndët ngjitëse të kompesatave Përdorimi i DDT si një infektues minimis në dikofol (maksimumi i përqendrimit 0.1%) Përdorimi i heptaklorit në artikujt në përdorim të përgjithshëm Përdorimi i hexaklorobenzene si infektues mimis në klorothalonil (maksimumi i përqendrimit 0.05%) Përdorimi i PCBs në artikujt në përdorim në përputhje me pjesën II të shtojcës së tanishme
Federata Ruse	Përdorimi i PCBs në tretësit dielektrike për pajisjet elektrike industriale Prodhimi i heptaklorit për përdorim në kutitë e kabllave nëntokësore dhe si tretës në pesticide Përdorimi i heptaklorit për përdorim në kutitë e kabllave nëntokësore dhe si tretës në pesticide Përdorimi i hexaklorobenzene si komponent ndërmjetës dhe si tretës në pesticide Prodhimi i DDT për vektorin e sëmundjeve në përputhje me pjesën II të shtojcës B të Konventës së Stokholmit mbi ndotësit organik të qëndrueshëm Përdorimi i DDT për vektorin e sëmundjeve në përputhje me pjesën II të shtojcës B të Konventës së Stokholmit mbi ndotësit organikë të qëndrueshëm
Arabia Saudite Sllovenia	Përdorimi i DDT për kontrollin e vektorit për qëllimet e shëndetit publik Përdorimi i PCBs së indentifikueshme në pajisjet që përmbajnë PCB-s në vëllime më të mëdha se 5 dm ³ dhe që kanë një përqendrim prej 0.05% PCB-s ose më shumë, sa më shpejt të jetë e mundur, dhe jo më vonë se 31 dhjetor 201 \$.
Afrika e Jugut	Përdorimi i PCBs në transformatorët që përmbajnë PCB-s Përdorimi i DDT për vektorin e sëmundjeve në përputhje me pjesën II të shtojcës B të Konventës së Stokholmit mbi ndotësit organikë të qëndrueshëm
Sudani	Përdorimi i DDT për kontrollin e vektorit në shëndetin publik në përputhje me udhëzimet e OBSH-së Përdorimi i PCBs tek transformatorët
Swaziland Uganda	Përdorimi i DDT në sektorin e shëndetit publik për kontrollin e malarjes Përdorimi i DDT për kontrollin e vektorit të sëmundjeve/shëndetin publik në përputhje me udhëzimet e OBSH Përdorimi i vazhduar i artikujve që përmbajnë PCBs në përputhje me shtojcat A dhe B
Republika e Bashkuar e Tanzanisë Shtetet e Bashkuara të Amerikës	Përdorimi i DDT për mbrojtjen e shëndetit të njerëzve (heqja e Republikës së Tanzanisë nga lista për përdorimin e hexaklorobenzene në shtojcën A). Përdorimi i heptaklorit në kutitë nëntokësore të kabllave
Jemeni	Përdorimi i DDT për vektorin e sëmundjeve në përputhje me udhëzimet e OBSH
Zambia	Përdorimi i kloradinës në rrugë Përdorimi i DDT për vektorin e sëmundjeve në përputhje me pjesën II të shtojcës B të Konventës së Stokholmit mbi ndotësit organikë të qëndrueshëm.

SHTOJCA VII
DOKUMENTET PËRPARA KOMITETIT NË SESIONIN E TIJ TË PESTË

SIMBOLI TITULLI

UNEP/POPS/INC:5/1 Axbenda e përkohshme
UNEP/POPS/INC: 5/2 Projektne B “Objektivi”
UNEP/POPS/INC: 5/3 Referimi në konventën e ardhshme mbi ndotësit organikë të qëndrueshëm tek Konventa e Baselit mbi kontrollin e lëvizjeve ndërkufitare të mbeturinave të rrezikshme dhe asgjësimi i tyre.
UNEP/POPS/INC: 5/4 Mbledhja ndërsesionale mbi burimet dhe mekanizmat financiarë e mbajtur në Vevey, Zvicër nga 19-21 qershor 2000: Raport nga kryetari
UNEP/POPS/INC: 5/5 Instrument detyrues ligjor ndërkombëtar për zbatimin e veprimit ndërkombëtar mbi ndotësit organikë të qëndrueshëm: Projekttekst nga kryetari
UNEP/POPS/INC 5/5 Add 1 Instrument detyrues ligjor ndërkombëtar për zbatimin e veprimit ndërkombëtar mbi ndotësit organikë të qëndrueshëm: Projekttekst nga kryetari
UNEP/POPS/INC 5/6 Propozim për projektrezolutat paraprake për adoptim të mundshëm nga konferenca e agjentëve diplomatikë me autoritet të plotë
UNEP/POPS/INC5/INF/1 Ndërqeveritar të negocimit
Njoftim i skenarit për sesionin e pestë të komitetit
UNEP/POPS/INC5/INF/2 Kostoja e rrjetit të asistencës për kapacitetin e përshkruar në nenin J his të tekstit të projektkonventës
UNEP/POPS/INCS/INF/3 Puna përkatëse mbi ndotësit organikë të qëndrueshëm sipas Konventës Baselit mbi kontrollin e lëvizjeve ndërkufitare të mbeturinave të rrezikshme dhe asgjësimi i tyre
UNEP/POPS/INCS/INF/4 Puna përkatëse mbi ndotësit organikë të qëndrueshëm sipas Organizatës Botërore të Ushqimit të Kombeve të Bashkuara
UNEP/POPS/INC/5 Lista origjinale e veprimeve mbi reduktimin dhe/ose eliminimin e shkarkimeve të ndotësve organikë të qëndrueshëm
UNEP/POPS/INCS/INF/6 Puna përkatëse mbi ndotësit organikë të qëndrueshëm sipas Fasilitetit të Mjedisit Global
UNEP/POPS/INCS/INF/7 Grafiku dhe nevojat financiare për përfundimin e negociemeve për një instrument detyrues ligjor ndërkombëtar për zbatimin e veprimit ndërkombëtar mbi disa ndotës organikë të qëndrueshëm
UNEP/POPS/INCS/NF/8 Sesioni i tretë i Forumit Ndërqeveritar mbi Sigurimin Kimik: Raporti përfundimtar
UNEP/POPS/INCS/INF/9 Puna përkatëse mbi ndotësit organikë të qëndrueshëm sipas Organizatës Botërore të Shëndetësisë
UNEP/POPS/INCS/INF/10 Dokumentet përpara Komitetit Ndërqeveritar të Negocimit për një instrument detyrues ligjor ndërkombëtar për zbatimin e veprimit ndërkombëtar mbi disa noq në sesionin e tij të pestë
UNEP/POPS/INC5/JNF/11/Rev.1 Lista e përkohshme e pjesëmarrësve
UNEP/POPS/INC5/INF/12/Rev.1 Lista e kërkesave për përjashtime të veçanta të vendeve në shtojcat A dhe B gjatë sesionit të pestë të komitetit
UNEP/POPS/INC.4/5/Corr.1 Raport për Komitetin Ndërqeveritar të Negocimit për një instrument detyrues ligjor ndërkombëtar mbi disa noq në sesionin e tij të pestë: ndreqje gabimesh